



**USAID**

NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



**DEMOCRACYPLUS**

# INTERPRETIMI RAST PAS RASTI I LIGJIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Raporti i monitorimit të OSHP  
(1 qershor – 31 dhjetor 2018)





# INTERPRETIMI RAST PAS RASTI I LIGJIT TË PROKURIMIT PUBLIK

**Raporti i monitorimit të OSHP  
(1 qershor – 31 dhjetor 2018)**

Prill 2019

**AUTOR:** Agon Hysaj

**ME KONTRIBUT TË:** Isuf Zejna

**EDITUAR NGA:** Roberta Osmani

Prill 2019

Ky raport është përgatitur nga Demokracia Plus (D+) dhe mbështetur nga USAID përmes aktivitetit Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (USAID TEAM). Qëndrimet e autorit të shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ose qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



# PËRMBAJTJA

<b>LISTA E SHKURTESAVE.....</b>	<b>6</b>
<b>PËRMBLEDHJE .....</b>	<b>7</b>
<b>HYRJE.....</b>	<b>8</b>
<b>OSHP NË PERIU DHËN QERSHOR – DHJETOR 2018 .....</b>	<b>9</b>
DALLIMET NË MES REKOMANDIMEVE TË EKSPERTËVE DHE VENDIMEVE TË PANELIT .....	11
VONESAT NË VENDIMMARRJE .....	12
AUTORITETET KONTRAKTUESE DHE OPERATORËT EKONOMIK ME MË SË SHUMTI VENDIME .....	13
<b>TRANSPARENCA .....</b>	<b>15</b>
<b>VENDIMET JOKONSISTENTE.....</b>	<b>16</b>
VENDIMET PËR LIGJIN E PUNËS / PAGËN MINIMALE.....	16
VENDIMET PËR NOSTRIFIKIM TË DIPLOMAVE.....	23
VENDIMET PËR VËRTETIMIN SE KOMPANITË NUK KANË BORXHE NDAJ ATK-SË.....	24
VENDIMET PËR ANKESAT NË KRITERE TË DOSJES SË TENDERIT .....	26
VENDIMET PËR PROKURIMET “BRENDA SHTËPISË” .....	27
VENDIMET PËR NENIN 61 – TENDER JONORMALISHT I ULËT .....	28
VENDIMET MBI PËRDORIMIN E FORMULËS PËR LLOGARITJE TË TENDERIT JONORMALISHT TË ULËT ..	30
LIBREZAT E AUTOMJETEVE ME REGJISTRIM TË SKADUAR .....	31
VENDIMET PËR MOSPLOTËSIM TË FORMULARIT PËR DORËZIM TË TENDERIT.....	32
SIGURIA E TENDERIT .....	33
VENDIMET JOKONSISTENTE PËR TENDER TË NJËJTË.....	34
VENDIM JOKONSISTENT BRENDA NJË VENDIMI .....	38
<b>VENDIMET PËR LISTËN E ZEZË.....</b>	<b>39</b>
<b>REKOMANDIMET E EKSPERTËVE .....</b>	<b>41</b>
REKOMANDIMET JOKONSISTENTE TË EKSPERTËVE .....	44
<b>REKOMANDIME .....</b>	<b>45</b>

## LISTA E SHKURTESAVE

<b>AK</b>	Autoriteti Kontraktues
<b>AQP</b>	Agjencia Qendrore e Prokurimit
<b>ATK</b>	Administrata Tatimore e Kosovës
<b>BQK</b>	Banka Qendrore e Kosovës
<b>DUD</b>	Dokumenti Unik Doganor
<b>IAP</b>	Institucioni i Avokatit të Popullit
<b>KEK</b>	Korporata Energjetike e Kosovës
<b>KRPP</b>	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
<b>LPP</b>	Ligji për Prokurim Publik
<b>MAP</b>	Ministria e Administratës Publike
<b>MASHT</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
<b>MFSK</b>	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës
<b>MSH</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>OE</b>	Operatori Ekonomik
<b>OEA</b>	Operatori Ekonomik Ankues
<b>OSHP</b>	Organi Shqyrtues i Prokurimit
<b>UA</b>	Udhëzim Administrativ
<b>Udhëzuesi</b>	Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik
<b>ZKA</b>	Zyrtari Kryesor Administrativ

# PËRMBLEDHJE

Ky raport shqyrton vendimet dhe praktikatat e OSHP-së për të vlerësuar se sa efektive kanë qenë masat të cilat janë ndërmarrë, por mbi të gjitha sa e paanshme ka qenë OSHP-ja në ndarjen e drejtësisë për palët. Periudha e monitorimit në këtë raport është 1 qershor – 31 dhjetor 2018, ku janë analizuar dhe krahasuar 479 vendime.

Gjetjet e raportit tregojnë për mungesë të konsistencës ndërmjet një numri të vendimeve të OSHP-së, të cilat bien në kundërshtim me vendimet paraprake. Në vazhdimësi D+ ka theksuar nevojën për standardizim më të madh të vendimeve të OSHP-së, në atë mënyrë që një vendim të jetë arsyeshëm i parashikueshëm nga palët, për shkak të ekzistimit të precedentit paraprak.

Numri i ankesave në vitin 2018 ka shënuar rritje të madhe dhe të papritur. Këtë vit janë dorëzuar 210 ankesa më shumë sesa në vitin 2017. Kjo përbën një rritje prej 38% në volumin e punës së OSHP-së, e cila funksionon me kapacitete minimale, pasi që vetëm tre anëtarë të OSHP-së nga pesë sa duhet t'i ketë sipas ligjit, janë duke ushtruar funksionin aktualisht, pasi të tjerët nuk kanë mandat. Kjo pastaj shkakton edhe vonesa në vendimmarrje, ku koha mesatare për marrje të një vendimi në periudhën 1 qershor – 31 dhjetor 2018 ka qenë 38.34 ditë, ndërsa afati ligjor është 34 ditë.

Çështje tjetër e trajtuar në këtë raport e që në OSHP shfaqet si dilemë e shpeshtë, është shqyrtimi i rasteve ku pretendimet ankimore nuk kanë të bëjnë me shkeljen e Ligjit të Prokurimit Publik, por ligjeve të tjera të veçanta apo akteve nënligjore. OSHP në disa vendime kishte përdorur arsyetim se në dosje të tenderit (DT) nuk është kërkuar që të respektohet Ligji i Punës prandaj mosrespektimi i tij nuk përbën shkelje për OSHP-në nëse nuk është kërkuar shprehimisht në DT. Megjithatë në një vendim tjetër kishte thënë që operatori ekonomik (OE) ankues nuk kishte ofruar tabela sinjalizuese sipas Udhëzimit Administrativ përkatës i cili nuk ishte kërkuar në dosje të tenderit. Në të dy rastet problem ishte se a duhet OSHP

të konsideroj ligjet tjera të aplikueshme ku ka pretendime për shkelje të tyre. Siç është përshkruar më lartë OSHP këtë çështje e ka trajtuar në mënyrë jo konsistente. Ky rast është vetëm një shembull se si vendimet e OSHP-së për çështje në esencë të njëjta, vendosen ndryshe nga paneli.

Për më tepër, ka raste kur paneli nuk merr vendim përfundimtar për një çështje, por të njëjtën e zvarrit duke e kthyer rastin në rivlerësim duke e bartur përsëri përgjegjësinë tek autoriteti kontraktues.

Një çështje tjetër e trajtuar janë edhe rekomandimet e gabuara që në disa raste kanë dhënë ekspertët. Paneli duke mos pasur njohuri të duhura në fusha të caktuara, në disa raste vendimin e merr duke u bazuar tërësisht në rekomandimet e ekspertëve.

Raporti gjithashtu ofron rekomandime rreth shmangies së vendimeve jokonsistente, vendimeve për listën e zezë, rritjes së transparencës si dhe shtimit të bashkëpunimit me prokurorinë.

# HYRJE

Një kompani e cila pretendon se është shpallur e papërgjegjshme në një aktivitet të prokurimit nga një entitet publik, në kundërshtim me rregullat dhe praktikën në prokurim publik, duhet të ketë një mënyrë të ankimit. Të tillë në Kosovë kompanitë e kanë organin Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP) që është e mandatar t'i mbrojë ato nga vendimet e paligjshme të autoriteteve kontraktuese.

Demokrasi Plus monitoron seancat e hapura të OSHP-së që nga dhjetori i vitit 2016. Qëllimi i këtij monitorimi është sigurimi i konsistencës dhe paanshmërisë në vendimmarrje. Përmes raporteve të kaluara dhe këtij aktual, D+ synon që të përmirësojë cilësinë e vendimmarrjes së OSHP-së, në mënyrë që vendimet të merren sa më shpejtë që është e mundur dhe të jenë sa më të drejta për palët. Po ashtu, D+ angazhohet që OSHP t'i arsyetojë mirë vendimet e saj, në mënyrë që një vendim të mos i shërbej thjeshtë një pale në proces, por të përbëjë edhe një precedent për rastet e ardhshme.

Vlen të përmendet transmetimi i seancave dëgjimore të OSHP-së në kohë reale, gjë e cila do t'i mundësojë palëve të interesuara që të përcjellin seancat e OSHP-së. Me këtë mënyrë, jo vetëm se do të shtohet transparenca e institucionit, por edhe autoritetet kontraktuese do të jenë më të vëmendshme për përfaqësimin që i bëjnë institucioneve të tyre pranë OSHP-së. Sipas vlerësimeve të monitoruesve të D+, disa institucione përfaqësohen shumë dobët në OSHP. Në disa raste kjo bëhet edhe në mënyrë të qëllimtë në mënyrë që të favorizohen operatorë të caktuar ekonomik. Me transmetimin e seancave në uebfaqe, të gjithë përfaqësuesit e institucioneve mund të mbahen në llogari për punën e tyre dhe përfaqësimin që i kanë bërë institucionit të vet.

Raporti vë në pah se ku qëndrojnë problemet me të mëdha të OSHP-së, njëkohësisht duke dhënë rekomandime se si OSHP t'i qaset një problemi të caktuar. Në fund të raportit janë edhe rekomandimet jo vetëm për OSHP-në se si të përmirësojë vendimmarrjen si dhe të rrit transparençën, por edhe institucionet e tjera si Kuvendi, Prokuroria dhe Qeveria.



Po ashtu, D+ angazhohet që OSHP t'i arsyetojë mirë vendimet e saj, në mënyrë që një vendim të mos i shërbej thjeshtë një pale në proces, por të përbëjë edhe një precedent për rastet e ardhshme.



# OSHP NË PERIUDHËN QERSHOR – DHJETOR 2018

D+ në periudhën 1 qershor deri më 31 dhjetor 2018 ka bërë monitorimin e seancave të hapura të OSHP-së<sup>1</sup>. Brenda kësaj periudhe janë marrë 479 vendime. Nga monitorimi i seancave,

vendimeve të panelit, ekspertizave dhe ankesave, D+ ka gjetur se OSHP për këtë periudhë ka proceduar:

Vendimi	Vendime të panelit	Rekomandime të ekspertëve
Vendim pro operatorit ekonomik ankues	269	255
Vendim pro autoritetit kontraktues	158	206
Njoftim	32	
Tërheqje e ankesës	20	
<b>Gjithsej</b>	<b>479</b>	<b>461</b>

**Tabela 1:** Procedimet në OSHP gjatë periudhës qershor-dhjetor 2018


Nga 479 vendime që OSHP ka marrë brenda kësaj periudhe, në favor të operatorëve ekonomik (OE) ankues (OEA) janë 269 vendime apo 63%, në 20 raste ankesat janë tërhequr dhe 158 vendime janë kundër operatorëve ekonomik ankues (OEA) apo 37%<sup>2</sup>. Në 19 vendime që janë pro OEA-ve, OSHP ka dhënë edhe urdhëresë për mosrespektim të vendimeve paraprake nga autoritetet kontraktuese (AK). Njoftimi nënkupton që OE dhe AK janë pajtuar me rekomandimin e ekspertit, ndërsa në këtë rast paneli vetëm nxjerr një njoftim.

Ekspertët shqyrtues kanë dhënë rekomandim në favor të OEA-ve në 255 raste, ndërsa rekomandim kundër OEA-ve

kanë dhënë në 206 raste. Mospërputhja në mes të numrit të vendimeve dhe numrit të rekomandimeve është për shkak se në disa raste tërheqjet e ankesave kanë ndodhur pa dhënë rekomandim ekspertit.

OE kryesisht ankohen kundër njoftimit për kontratë, njoftimit për dhënie të kontratës dhe njoftimit për anulim të tenderit. Numri më i madh i ankesave bëhet kundër njoftimit për dhënie të kontratës. Megjithatë ka shumë raste kur OE ankohen kundër njoftimit për dhënie por në ankesë ka shumë pika që kanë të bëjnë me kriteret e tenderit për të cilat OE duhet të ankohen kundër njoftimit për kontratë.


- OSHP mbanë dy lloje të takimeve, të hapura për palët dhe publikun dhe takime të brendshme, ku palët tjera nuk lejohen të marrin pjesë. D+ si organizatë monitoruese, përkundër që ka të nënshkruar memorandum të mirëkuptimit me OSHP-në, nuk lejohet që të monitorojë edhe ato seanca ku nuk janë ftuar palët.
- Vendimet për tërheqje të ankesës nuk janë llogaritur në përqindje pasi paneli nuk merr vendim pro ose kundër ankuesit, por vetëm pranon tërheqjen e ankesës.



**Tabela 2:** Ndarja e ankesave sipas llojit të ankesës për periudhën qershor-dhjetor 2018

Nga 479 vendime të marra në këtë periudhë, për 427 prej tyre është mbajtur seancë dëgjimore ku 386 kanë qenë seanca të hapura dhe 41 seanca të mbyllura. Për 52 vendime

tjera nuk është mbajtur seancë si rezultat i tërheqjes së OE nga ankesa, apo për shkak të pajtimit të OE dhe AK me rekomandimin e ekspertit.



**Tabela 3:** Numri i seancave për periudhën qershor-dhjetor 2018

## Dallimet në mes rekomandimeve të ekspertëve dhe vendimeve të panelit

Në 269 vendime që ishin pro kompanive ankuese, ekspertët kanë dhënë rekomandim të kundërt në 84 raste ose 31%. Në 158 vendime që paneli ka marrë kundër kompanive ankuese,

ekspertët kanë rekomanduar ndryshe prej panelit në 46 raste ose 29%. Në përgjithësi vendimet e panelit dhe rekomandimet e ekspertëve nuk përputhen në 130 raste ose 30%.

Eksperti	Rekomandime pro OEA	Rekomandime kundër OEA	Vendime të panelit pro OEA	Vendime të panelit kundër OEA
Abdurrahman Çunaku	3	0	2	1
Abetare Prebreza	4	7	5	6
Agim Sheqiri	9	6	8	7
Basri Fazliu	18	28	33	13
Besnik Mehmeti	4	2	4	2
Bujar Sopi	9	5	9	5
Burim Guri	2	6	2	6
Es'heme Beka	4	0	3	1
Hasim Krasniqi	16	16	22	8
Hysni Muhadri	10	20	16	14
Muhamet Kurtishaj	8	9	7	10
Nazmi Statovci	8	6	11	3
Qazim Hoxha	5	9	7	7
Safiye Saramati	10	6	10	6
Sahit Beqiri	16	8	15	9
Visar Basha	20	19	25	14
Visar Bibaj	22	11	22	11
Vjollca Balaj	7	3	8	2
Xhevdet Bushi	13	6	13	6

**Tabela 4:** Rekomandimet pro dhe kundër OEA sipas ekspertëve si dhe vendimet e panelit për ato rekomandime

Nga tabela më lartë vërehet se për ankesat ku ekspert ka qenë Basri Fazliu dhe Hysni Muhadri ka dallim të madh në mes të rekomandimit të dhënë dhe vendimit të panelit.

## Vonesat në vendimmarrje

OSHP pas pranimit të ankesës ka 34 ditë kohë për të marrë vendim dhe për ta publikuar të njëjtin në uebfaqe. Prej 1 qershor e deri më 31 dhjetor 2018 OSHP ka marrë 479 ven-

dime. Koha mesatare prej datës së ankesës deri në datën e publikimit është 38.34 ditë, e cila tejkalon afatin ligjor prej 34 ditëve.

Nr.	Aktiviteti i prokurimit	OE ankues	AK	Ditët
1	Furnizim me pompa centrifugale horizontale për largimin e ujit	ND	KEK	77
2	Furnizim me drunj dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës	Lulishtja Buçaj	KK Prishtinë	73
3	Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve në fshatrat dhe qytetin e komunës së Gjilanit llot 1	Zuka Commerce	KK Gjilan	73
4	Furnizim me barna nga Lista Esenciale Llot 6,8,9,12,16,34,39 dhe 40	Liri Med	MSH	69
5	Sigurimi fizik i objekteve për AK- Vushtrri	Commando	KK Vushtrri	68
6	Furnizimi, instalimi dhe lëshimi në punë i ndriçimit në Obiliq	Risamont	KEK	66
7	Sigurimi fizik i objekteve të APK-së	SFK	Agjencia Pyjore e Kosovës	63
8	Shërbimet e projektimit dhe dizajnit të projekteve të infrastrukturës për nevojat e MFSK-së dhe FSK-së	Arhiko Ing	MFSK	62
9	Shërbimet e transportit të punëtorëve të KEK-ut llot 2	Autotransporti	KEK	60
10	Ndërtimi i qarkores së Gjakovës Llot I	PeVlaku & Joos & Krasniqi Bazë	KK Gjakovë	60

**Tabela 5:** Dhjetë vendimet për të cilat OSHP është vonuar më së shumti për të marrë vendim.

## Autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik me më së shumti vendime



Gjatë kësaj periudhe, vendime më së shumti ka pasur kundër këtyre AK-ve:<sup>3</sup>

AUTORITETI KONTRAKTUES	NUMRI I VENDIMEVE	FITUARA↑	HUMBURA↓
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS	55	15	40
KEK	47	23	24
KOMUNA E PRISHTINËS	21	7	14
MINISTRIA E SHËNDETËSISË	19	9	10
KOMUNA E GJAKOVËS	18	5	13
POLICIA E KOSOVËS	17	5	12
KOMUNA E GJILANIT	16	6	10
QKUK	11	6	5
KOMUNA E VITISË	11	3	8
KOMUNA E LIPJANIT	11	8	3

**Tabela 6:** Autoritet kontraktuese me më së shumti vendime nga OSHP në periudhën qershor – dhjetor 2018

Nga tabela më lart shihet se vetëm QKUK dhe Komuna e Lipjanit kanë fituar raste më shumë në OSHP se që kanë humbur. Të gjitha autoritet tjera kanë humbur më shumë sesa që kanë fituar. Ministria e Infrastrukturës ka humbur në 72% të vendimeve, përderisa mesatarja e rasteve të humbura për këtë periudhë është 63%.

<sup>3</sup> Ankesat që një OE i ka bërë për dy lloje, janë llogaritur si dy ankesa pasi ka raste kur ankesa për një llot është refuzuar, ndërsa për tjetrin është aprovuar.

OE ANKUES	NUMRI I VENDIMEVE	FITUARA 	HUMBURA 
JOOS & KRASNIQI BAZË	10	8	2
LIRI MED	9	4	5
ESKAVATORI	8	4	4
EL BAU	7	5	2
SFK	7	6	1
INTERLAB	6	3	3
CTA	6	3	3
SALLAHU	6	6	0

**Tabela 7:** Operatorët ekonomik me më së shumti vendime nga OSHP në periudhën qershor – dhjetor 2018

Në tabelën 7, vendim për operatorin ekonomik është llogaritur edhe kur ka qenë në konzorcium me ndonjë OE tjetër.

# TRANSPARENCA

Gjatë kësaj periudhe raportuese, në përgjithësi njoftimi i palëve është bërë me kohë, por në raste të kufizuara kanë ndodhur gabime si për shembull emaili i dërguar në adresë të gabuar dhe kështu ka ndodhur që njëra nga palët mos të jetë në seancë. Publikimi i njoftimeve për seanca në faqen e OSHP-së zakonisht bëhet me kohë, përveç në disa raste kur njoftimi publikohet ditën kur do të mbahet seanca. Mungesa e palëve në seancë qoftë për arsye se nuk është njoftuar, qoftë për arsye të panjohura nuk e pengon mbajtjen e seancës. Vetëm në raste të rralla seanca shtyhet për mungesë të palëve, sipas kërkesës së palëve drejtuar panelit. Pasi kjo periudhë përfshin edhe sezonin veror, shumica e ekspertëve kanë qenë në pushime vjetore dhe gjatë muajit gusht ka pasur mungesa të shumta të ekspertëve në seanca. Kjo e ka vështirësuar vendimmarrjen e panelit për shkak të pamundësisë për të dhënë sqarime shtesë në ekspertizat e ofruara për panelin.

Si rezultat i avokimit të vazhdueshëm nga D+, numri i seancave të hapura është rritur dhe kjo përbën një rast për më shumë monitorim jo vetëm nga organizatat joqeveritare, por edhe mediat e qytetarët.

Për më tepër OSHP në dhjetor 2018 ka filluar të testojë transmetimin direkt të seancave të hapura me përkrahjen e Programit të Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtarë të Shteteve të Bashkuara (USAID) për Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (TEAM). Pas testimit, nga viti 2019 do të bëhet transmetimi i drejtpërdrejt i seancave të hapura.

Siç është theksuar edhe në raportet e kaluara, mungesë të transparencës ka në publikimin e ankesave, ku publikohen vetëm dy faqet e para, të cilat nuk përmbajnë pikat ankimore të OEA. Dokument tjetër jopublik mbetet edhe ekspertiza e cila i dorëzohet palëve dhe panelit. Edhe pse OSHP bën publikimin e vendimeve, formati elektronik i tyre është vështirë i lexueshëm nga kompjuteri. Në këtë format nuk mund të kërkohe brenda një vendimi për të gjetur më lehtë fjalët e kërkuara.



Siç është theksuar edhe në raportet e kaluara, mungesë të transparencës ka në publikimin e ankesave, ku publikohen vetëm dy faqet e para, të cilat nuk përmbajnë pikat ankimore të OEA. Dokument tjetër jopublik mbetet edhe ekspertiza e cila i dorëzohet palëve dhe panelit.

# VENDIMET JOKONSISTENTE

Shumë ankesa kanë ngjashmëri mes vete për sa i përket pretendimit ankimorë. Kjo pasi që shumë institucione kryejnë veprime të kundërligjshme që janë të përsëritura edhe nga institucionet e tjera. Të tilla raste mund të konsiderohen, shpërblymi me kontrata të kompanive të cilat kanë paraparë rroga të cilat bien në kundërshtim me rrogën minimale, apo nuk kanë kalkuluar pushimet vjetore të punëtorëve, nuk kanë nostrifikuar diplomat universitare, apo probleme të ngjashme. Në këto raste, D+ vlerëson nëse OSHP i trajton me të njëjtin standard këto ankesa.

Në ato vendime ku vërehet se OSHP ka marr një vendim i cili është i kundërt me një paraprak, D+ e identifikon të njëjtin si vendim jokonsistent.

Në pjesën në vazhdim mund të lexoni për vendime jokonsistente për shumë çështje. Jokonsistenca ka ndikime negative në shumë dimensione, duke përfshirë krijimin e pasigurisë juridike në prokurim publik, humbjen e besimit të palëve në OSHP dhe rritjen e dyshimeve për anësi në trajtimin e lëndëve nga ekspertët dhe paneli.

## Vendimet për Ligjin e Punës / Pagën minimale

Për të nxjerrur të dhëna në lidhje me rastet jokonsistente, D+ ka analizuar të gjitha vendimet që janë marrë në periudhën qershor – dhjetor 2018. Një shqetësim lidhur me këto vendime është vëmendja që OSHP i jep vetëm shkeljeve të LPP-së dhe jo edhe ligjeve të tjera domosdoshmërisht. Përkundër faktit se shkelja e cilitdo ligj të aplikueshëm do të duhej ta bënte procedurën e pavlefshme, OSHP në disa raste i toleron ato. Në përgjithësi nëse ekziston ndonjë kërkesë që buron nga ndonjë ligj tjetër, por që nuk vendoset në dosjen e tenderit si kërkesë specifike, atëherë ekspertët dhe paneli e cilësojnë që “kërkesa nuk ka qenë pjesë e dosjes së tenderit”. Megjithatë paneli ka filluar që t’i ketë parasysh kërkesat që burojnë nga ligjet tjera. Për tenderët ku kërkohet respektimi i tarifave të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), paneli merr vendim duke i pasur parasysh këto tarifa, pavarësisht a kërkohen në dosje të tenderit apo jo.

Por kjo gjë nuk po ndodh me Ligjin e Punës dhe Vendimin e Qeverisë së Kosovës për përcaktimin e pagës minimale, ku në tenderët për sigurim fizik të objekteve ka vendime të panelit dhe rekomandim të ekspertëve me arsyetime që nuk ka qenë kriter që të zbatohet Ligji i Punës apo vendimi për pagë minimale. Paneli në një vendim të vitit 2017 i ka dhënë rëndësi një Udhëzimi Administrativ i cili nuk ishte kërkuar në dosjen e tenderit. Paneli në vendimin 394-402/17<sup>4</sup> kishte vendosur që të anulohet tenderin për shkak që OE ankues, RSM Company, tabelat e rrugëve nuk i kishte ofruar sipas UA 13/2012 të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor<sup>5</sup>, i cili UA nuk ishte kërkuar në dosje të tenderit. Mirëpo paneli nuk vepron njëjtë edhe kur kërkesë në dosje nuk është që të respektohet Ligji i Punës, apo edhe në ato raste kur është kërkesë nuk po respektohet në tërësi ky ligj.

4 OSHP. Vendimi 394-402/17. 2017. [https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2017/394-402-17vendim\\_1.PDF](https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2017/394-402-17vendim_1.PDF)

5 Udhëzimi Administrativ Nr. 13/2012 për Vendosjen Fizike të Tabelave të Adresave në Zona të Qarkullimit Publik, Ndërtesa, Shtëpi, Objekte dhe Zona Kadastrale të Lira. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. 2012. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8190>



Mosrespektimi i ligjit të punës dhe pagës minimale bën që punëtorët të punojnë në kushte të vështira, me orar të punës të stërzgjatur dhe pagesë për orë nën minimumin e llogaritur sipas pagës minimale. Edhe në rastet kur kërkesa për respektim të Ligjit të Punës ka qenë pjesë e dosjes së tenderit dhe kur është caktuar paga në dosje, ekspertët dhe paneli bëjnë llogaritje bazike për të parë se a arrin OE ankues ose i rekomanduar që të kryejnë obligimet ndaj punëtorëve me çmimin e ofruar. Llogaritja që bëhet është paga (bruto ose neto), tatimi në pagë, kontributi pensional i të punësuarit dhe punëdhënësit. Në bazë të Ligjit të Punës, neni 56.2 mbi pagën bazë bëhen edhe këto pagesa:<sup>6</sup>

2. Të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si më poshtë::

2.1. 20% në orë për kujdestari;

2.2. 30% në orë për punë gjatë natës;

2.3. 30% në orë për punë jashtë orarit;

2.4. 50% në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe

2.5. 50% në orë për punë gjatë fundjavës.

Këto llogaritjet tjera nuk i bëjnë as ekspertët e as paneli. Paga neto + tatimi në pagë + kontributi pensional i të punësuarit + kontributi pensional nga punëdhënësi + pagesa shtesë në bazë të nenit 56.2 përbëjnë shpenzim për OE. Ky është një prag, ku nëse ka oferta nën të, atëherë janë me çmim jonormalisht të ulët. OSHP për këtë çështje do të mund të zhvillonte një formulë të llogaritjes së këtyre çmimeve, sidomos në rastet e tenderëve për sigurim fizik, apo pas-trim të objekteve, ku ky problem shfaqet më shpesh. Për të njëjtën çështje, OSHP do të mund të konsultohej edhe me

Inspektoratin e Punës në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, siç parashihet në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative<sup>7</sup>.

D+ thekson nevojën që OSHP t'i kushtojë një vëmendje më të madhe shkeljeve të ligjeve të veçanta në çdo rast që diçka e tillë identifikohet. Në rastet kur OSHP e konsideron veten jokompetente, t'i referoj këto çështje në institucionet përkatëse, por në asnjë mënyrë këto raste të mos mbesin të patrajtuara. Për më tepër edhe në Kushtet e Përgjithshme të dosjeve të tenderit theksohet që OE duhet të veprojë sipas ligjeve në fuqi në Kosovë. Neni 7.3 i Dosjes së Tenderit për Furnizim thotë:

7.3 Furnizuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.<sup>8</sup>

Njëjtë thotë edhe neni 8.2 i Kushteve të Përgjithshme për Dosjen e Tenderit Punë.

## SFK v. Institucioni i Avokatit të Popullit, 210/18

Kompania SFK ishte ankuar kundër Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) për tenderin "Sigurimi fizik i objektit të IAP-së" me pretendimin se është shkelur neni 61 i LPP-së. Eksperti shqyrtues Besnik Mehmeti thotë që vlerësimi i çmimit është e drejtë e AK-së, dhe pasi AK nuk ka pasur dyshime në çmim, rekomandon që ankesa të refuzohet. Paneli vendosi që ankesa të refuzohet duke u bazuar në rekomandimin e ekspertit<sup>9</sup>.

IAP kishte paraparë buxhet prej 10,000 euro për sigurim fizik të objektit për 24 orë në ditë për 12 muaj. Pasi IAP nuk e

6 Ligji Nr. 03/L-212 i Punës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. 2010. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2735>

7 Neni 34, Ndihma administrative: 1. Organi publik mund t'i kërkojë ndihmë (në vijim "ndihma administrative") një organi tjetër publik, për kryerjen e një a disa veprimeve të nevojshme procedurale, në kuadër të një procedure administrative. 2. Ndhma administrative kërkohet: 2.1. nëse për arsye të justifikuara, organi kërkues, nuk mund t'i kryejë vetë këto veprime; 2.2. nëse kryerja e veprimeve nga organi kërkues nuk është efektive apo koston për kryerjen e tyre janë shumë më të larta në krahasim me koston e kryerjes së tyre nga organi tjetër; 2.3. për njohjen me fakte, dokumente apo mjete të tjera të provës në posedim të organit tjetër; 3. Përveç kur parashikohet ndryshe me ligj, organi publik mund ta zgjedhë organin, të cilit i kërkon ndihmë, në përputhje me parimin e kosto-efektivitetit.

8 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. B15 Dosja e Tenderit – Furnizim – Procedura e hapur. 2016. <https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/STRforms2016/Shqip/B15.docx>

9 OSHP. Vendimi 210/18. 2018. <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/210-18vend.pdf>

ka përcaktuar pagën e punëtorëve në dosje të tenderit, për llogaritje është marrë paga minimale sipas vendimit 04/33 të Qeverisë së Kosovës<sup>10</sup>, ku paga minimale është përcaktuar 130 euro për të punësuarit nën moshën 35 vjeçare dhe 170 euro për ata mbi 35 vjet. Udhëzimi Administrativ (UA) 09/2017 i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale<sup>11</sup> përcakton që paga minimale është pagë bruto si dhe numri maksimal i orëve që një punëtor mund të punojë brenda një muaji është 176 orë.

Oferta e OE fitues Commando ishte 6,512.18 euro për 12 muaj, që për një muaj është 542.68 euro. Pasi IAP kishte kërkuar sigurim 24 orë, në një muaj janë 720 orë (24 orë \* 30 ditë). Për të punuar 720 orë nevojiten katër punëtorë që do të punonin nga 180 orë në muaj. Po të bëhet llogaritje bazike ku një punëtorë paguhet 130 euro bruto në muaj duke punuar 176 orë plus 5% të kontributit të punëdhënësit shpenzimet e OE fitues do të ishin:

**130 \* 1.05 = 136.5 Eur**

**4 punëtorë \* 136.5 = 546 Eur**

Shpenzimet e OE Commando janë më të larta se oferta e tij pa llogaritur këtu katër orë shtesë që punëtorët do të punonin në muaj (180 – 176), pagesën shtesë prej 30% për orë të natës, pagesën për festa, pushimet vjetore.

Paneli do të duhej që lëndën ta kthente në rivlerësim dhe ta detyronte AK që të llogaritet pragu i shpenzimit nën të cilën ofertat janë jonormalisht të ulëta. Këtë e thotë edhe neni 18.25 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (më tutje Udhëzuesi)<sup>12</sup> i cili thotë:

*18.25 Në rast se çmimi i ofruar nga Ofertuesi nuk mbulon pagat minimale të punonjësve që do të përfshihen në ekzekutimin e kontratës, e rregulluar nga Ministritë në sektorë të ndryshëm, oferta mund të konsiderohet si ofertë jonormalisht e ulët. Gjatë përcaktimit të pagave minimale dhe pagave që do t'u paguhet të punësuarve, Autoritetet Kontraktuese dhe Ofertuesit duhet të respektojnë pagat minimale të kërkuara dhe taksat dhe kontributet sociale përkatëse të publikuara në sektorët përkatës. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë informacion lidhur me pagat minimale përkatëse të zbatueshme nga ana e operatorit ekonomik gjatë vlerësimit të arsyetimeve të dorëzuara nga operatorët ekonomik.*

Është e drejtë e AK-së vlerësimi i çmimit jonormalisht të ulët, por kjo nuk e amnistion asnjë institucion nga përgjegjësia për të respektuar pagën minimale apo ndonjë obligim tjetër ligjor. Pasi që edhe me ligj, në ushtrimin e kompetencës diskrecionale, parimi i ligjshmërisë përmendet shprehimisht si kusht për t'u konsideruar veprimi administrativ si i ligjshëm.<sup>13</sup>

## **Rojet e Nderit v. Prokuroria e Shtetit, 415/18**

Në tenderin “Sigurimi fizik i objekteve të Sistemit Prokurorial të Kosovës” paneli merr vendim jokonsistent krahasuar me vendimin për IAP. Në atë vendim OSHP ka kërkuar që lënda

10 Qeveria e Kosovës. Vendimi 04/33. 2011.

[http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet\\_e\\_mbledhjes\\_se\\_33-te\\_te\\_Qeverise\\_2011.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_mbledhjes_se_33-te_te_Qeverise_2011.pdf)

11 Udhëzim Administrativ 09/2017 për caktimin e pagës minimale. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. 2017. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15812>

12 Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik. 2017. <https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/2018/04/rruopp13042018.pdf>

13 Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Neni 4. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. 2016 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12559>

të kthehet në rivlerësim me arsyetimin që AK duhet të vërtetojë se a mundet OE fitues me çmimin e ofruar t'i paguajë punëtorët sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë<sup>14</sup>. Ky vendim i OSHP-së ishte nxjerrë edhe pse diçka e tillë nuk ishte kërkuar në dosje të tenderit. Këtë paneli e thotë pa bërë ndonjë llogaritje se a ka ofruar OE fitues duke respektuar Ligjin e Punës dhe pagën minimale.

Ekspteri shqyrtues Hasim Krasniqi kishte dhënë rekomandim që ankesa të refuzohet pasi AK nuk kishte kërkuar në dosje të tenderit që të respektohet Ligji i Punës, ndërsa neni 61 dhe formula për të përcaktuar një tender me çmim të ulët nuk mund të përdorej pasi ishte vetëm një ofertë nën buxhetin e planifikuar. LPP në nenin 61 thotë që nëse një tender duket që është jonormalisht i ulët, atëherë AK do të kërkojë sqarime nga operatori ekonomik. Neni 61.6 thotë se KRPP nxjerr

akt nënligjor për të përcaktuar çmimin jonormalisht të ulët. KRPP ka nxjerrë dokumentin B57 – Rregullat mbi përcaktimin e tenderit jonormalisht të ulët<sup>15</sup>. Për t'u cilësuar një tender jonormalisht i ulët duhet të plotësohen këto tri kushte:

- 1 çmimi i ofruar është më shumë se **30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm**;
- 2 çmimi i ofruar është më shumë se **10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët**;
- 3 janë dorëzuar të paktën **3 (tre) tenderë**.

Nëse një ofertë tejkalon buxhetin ajo është e përgjegjshme, por nuk zgjedhet fituese pasi zakonisht ka oferta më të lira. Në këtë tender ishin katër oferta;

## OPERATORI

COMMANDO & GROUP FOR SECURITY & JONI

ROJET E NDERIT

ALPHA PRIVATE SECURITY & SAS

AS SECURITY & BESA SECURITY

## ÇMIMI

**36,540.48 Eur**

**48,545.28 Eur**

**51,517.44 Eur**

**55,480.32 Eur**

**Tabela 8:** Operatorët ofertues në aktivitet të prokurimit dhe çmimet e ofruara

14 OSHP. Vendimi 415/18. 2018.  
[https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/415-18vendim\\_1.PDF](https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/415-18vendim_1.PDF)

15 KRPP. B57 Rregullat për tenderët jonormalisht të ulët – versioni i korrigjuar. 2017.  
[https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/STRforms2016/Shqip/Rregullat%20per%20Tenderet%20Jo-Normalisht%20te%20Ulet\\_v2\\_07\\_07\\_2016.docx](https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/STRforms2016/Shqip/Rregullat%20per%20Tenderet%20Jo-Normalisht%20te%20Ulet_v2_07_07_2016.docx)

AK kishte zgjedhur fitues konzorciumin Commando & Group for Security & Joni. Duke përdorur formulën më lartë, atëherë pragu për të cilësuar një çmim si jonormalisht të ulët është:

$$36,540.48 + 48,545.28 + 51,517.44 + 55,480.32 = 192,083.52$$

$$192,083.52 / 4 \text{ oferta} = 48,020.88 \text{ mesatarja e ofertave}$$

$48,020.88 / 1.3 = 36,939$  euro është pragu ku të gjitha ofertat nën këtë çmim janë jonormalisht të ulëta.

$$48,545.28 - 36,540.48 = 12,004.8$$

$12,004.8 / 48,545.28 = 0.247$  apo **24.7% më e ulët se oferta e dytë e gjithashtu janë tri oferta të përgjegjshme.**

Eksperti shqyrtues po ta bënte këtë llogaritje atëherë rekomandimi do të duhej të ishte që të aprovohej ankesa, ndërsa OE fitues të shpallet i papërgjegjshëm.

Mirëpo, pas rivlerësimit AK prapë shpall fitues të njëjtin OE, ndërsa OE Rojet e Nderit bën ankesë përsëri. Paneli e kthen tenderin në rivlerësim edhe njëherë<sup>16</sup>, por tani duke dhënë arsytim kundërthënës. Përderisa në vendimin e parë kishte thënë që AK të vërtetojë se a mundet OE fitues t'i paguajë punëtorët me çmimet e ofruar, në vendimin e dytë thotë që në dosje të tenderit nuk është kërkuar që të respektohet Ligji i Punës dhe paga minimale. Në të njëjtin vendim dy paragrafë më lartë paneli thotë që nuk është respektuar ven-

dimi i kaluar. Paneli gjithashtu si arsytim thotë që nuk janë përmbushur kushtet që tenderi të cilësohet si jonormalisht i ulët në bazë të formulës, kur në fakt ato janë plotësuar siç dëshmohet nga llogaritja më lartë.

Eksperti shqyrtues ndryshon rekomandimin e tij në vendimin e dytë duke rekomanduar që të aprovohej pjesërisht ankesa dhe tenderi të kthehet në rivlerësim. Përderisa në vendimin e parë kishte thënë që Ligji i Punës dhe paga minimale nuk janë kërkuar të respektohen, në vendimin e dytë duke u bazuar në arsyetimin e panelit që kishte dhënë në vendimin e parë thotë që AK nuk ka vërtetuar se a mundet OE fitues t'i paguajë punëtorët me çmimin e ofruar. Arsyetimin për nenin 61 e përsërit si në vendimin e parë. Në fakt në vendimin e dytë rekomandimi i ekspertit dhe arsytimi i panelit kanë tekst të njëjtë.

Pas rivlerësimit Prokuroria e Shtetit anulon tenderin me arsyen se të gjitha ofertat janë të papërgjegjshme.

## Rojet e Nderit v. Komuna e Gjakovës 547/188

Komuna e Gjakovës kishte shpallë fitues të tenderit "Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës" konzorciumin Internat Security Association & M-GR Security me çmim 251,269.20 euro. Kohëzgjatja e kontratës do të ishte 24 muaj. Kundër këtij vendimi OE Rojet e Nderit u ankua në OSHP me pretendimin që nuk janë respektuar kërkesat e dosjes së tenderit për pagën. Paga që kërkohej ishte 300 euro bruto plus të gjitha obligimet tjera që dalin nga Ligji i Punës. Komuna kishte shënuar si vërejtje se nëse një OE nuk arrin pagën bruto tenderi i tij do të cilësohej si jonormalisht i ulët dhe do të refuzohej. Duke u mbështetur në rekomandimet e ekspertës shqyrtuese Abetare Prebreza, paneli vërtetoi njoftimin për dhënie të kontratës<sup>17</sup>. Arsyetimi i panelit është i njëjtë fjalë për fjalë si rekomandimi i ekspertës, duke thënë

16 OSHP. Vendimi 627/18. 2018  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/627-18vend.pdf>

17 OSHP. Vendimi 547/18. 2018.  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/547-18%20vend.pdf>

që sipas llogaritjes së bërë dhe kërkesave të AK, konzorciumi fitues mund të paguajë punëtorët me çmimin e ofruar.

Ekspertja shqyrtuese Abetare Prebreza rekomandon që ankesa të refuzohet pasi sipas llogaritjes që bën ajo paga për një punëtor për një muaj do të ishte 327.17 euro.

$251,269.20$  ( oferta e konzorciumit ) / 24 muaj (kohëzgjatja e kontratës) / 32 (numri i punëtorëve të kërkuar) = 327.17 euro.

Mirëpo, ekspertja ka bërë llogaritje të gabuar duke mos marrë parasysh kërkesat e dosjes së tenderit dhe Ligjin e Punës. Konkretisht, nuk është llogaritur fare kontributi i punëdhënësit (që është një shpenzim për kompaninë) dhe pagesat tjera siç është ndërrimi i natës dhe pushimi vjetor. Po të llogaritej ndërrimi i natës prej plus 30% për orë, çmimi i ofruar për orë që është 1.17 euro dhe fakti që janë 24 muaj që nënkuptojnë 730 ndërrime të natës (2 vite nga 365 ditë), dhe llogaritja e ndërrimit të natës sipas Ligjit të Punës që është nga ora 22:00 deri në 06:00, atëherë shpenzimi shtesë do të ishte:

**$1.17 * 0.3 = 0.35$  Euro  
shpenzim shtesë për një orë.**

**$0.35$  Eur \* 8 orë\*  
730 ditë = **2,044** Euro**

Në dosje të tenderit komuna ka kërkuar që në shtatë lokacione të ketë roje 24 orë, e që nënkupton që secila prej tyre e ka nga një ndërrim të natës.

**$2,044 * 7 = 14,308$  Euro**

**është shpenzimi shtesë vetëm për pagesë të ndërrimit të natës.**

Kjo llogaritje tregon që OE fitues nuk do të mund të mbulonte pagën bruto dhe shpenzimet tjera.

Problemi tjetër që ekspertja nuk e ka vërejtur e që OE ankues e ka përmendur gjatë seancës, është numri i orëve që një punëtor do të duhet të punojë. Numri i orëve të kërkuara në dosje të tenderit është 182,000 orë për 24 muaj. Kur kjo shumë pjesëtohet me numrin e punëtorëve del që një punëtorë duhet të punojë 237 orë në muaj.

**$182,000 / 24 / 32 =$**

**237 orë për muaj**

Me këto dy llogaritje, një punëtor përveç se nuk do të mund të paguhet 300 euro bruto së bashku me shpenzimet e kontributit pensional të punëdhënësit dhe pagesat tjera që i takojnë me ligj, do të duhet të punojë 61 orë më tepër në muaj se sa norma e lejuar me ligj dhe UA.

Ekspertja më tej arsyetohet që komuna e ka sqaruar përmes kërkesave për sqarim që kanë bërë OE se si definohej të drejtat elementare sipas Ligjit të Punës. Komuna është përgjigjur që ju ka referuar pagës dhe pushimit vjetor duke shtuar që punëtorëve ju takojnë të gjitha të drejtat e cekura qartazi me ligj. Komuna ka si shqetësim vetëm faktin që për festa nuk mund të pushojnë të gjithë punëtorët njëherësh por të bëhet një zgjidhje. Ekspertja e interpreton këtë që komuna ka kërkuar të respektohet vetëm paga dhe pushimi. Megjithatë as komuna e as ekspertja nuk mund të përcaktojnë të drejta themelore të një ligji.

Ekspertja më tej thotë që nuk është kërkuar të bëhet analizë financiare. Kjo është e vërtetë, por analiza financiare bëhet për të parë se a kanë ofruar OE sipas kushteve të dosjes së tenderit dhe Ligjit të Punës. Po të bëhej analiza financiare do të vërehej që sasia e orëve e kërkuar së bashku me numrin e punëtorëve nuk mbulohen me buxhetin e parashikuar që ka qenë 290,000 euro. Si pasojë e kësaj tenderi do të duhej të anulohet për shkak që me buxhetin e parashikuar nuk mund

të paguhen 32 punëtorë duke punuar 176 orë në muaj. Nga llogaritja e mëposhtme mund të shihet që për 182,000 orë që ishin kërkuar, për 24 muaj duhen së paku 43 punëtorë.

$$182,000 / 24 / 176 =$$

**43.08 punëtorë**

Nga numri prej 43 punëtorëve po të llogariten vetëm shpenzimet e pagave dhe kontributit pensional (300 euro plus duke ja shtuar 5% të punëdhënësit) atëherë shpenzimet do të ishin:

$$43 * 315 * 24 =$$

**325,080 Euro**

Paneli shqyrtues në këtë rast ka marrë vendim jokonsistent krahasuar me vendimin për Prokurorinë e Shtetit, pasi tani është kërkuar në dosje të tenderit që të respektohet Ligji i Punës, por paneli përmes llogaritjes së gabuar të ekspertës ka marrë vendim të gabuar.

### SFK v. Agjencia Pyjore e Kosovës, 553/18

Një vendim tjetër është për tenderin “Sigurimi fizik i objekteve të APK-së”, ku paneli aprovon ankesën e OE SFK dhe kthen tenderin në rivlerësim<sup>18</sup>. Arsytimi i vetëm i panelit ishte që AK të bëjë llogaritjen e çmimeve të ofruara nga OE dhe t’i ketë parasysh kriteret e dosjes së tenderit. Në dosje të tenderit nuk kishte kërkesë të qartë që të respektohej Ligji i Punës, por kërkohej vetëm një deklaratë nga OE fitues se do ta respektojë Ligjin e Punës dhe rregullat tjera lidhur me pagat. Këtë kërkesë AK e kishte përsëritur edhe në kërkesën për sqarim që kishin bërë OE duke thënë:

*Ne kemi kërkuar që të respektohet Ligji i Punës nga ofruesi i shërbimeve, kurse sa i përket kalkulimit të çmimit është e drejtë e ofruesit të shërbimeve se si e bënë atë. Kalkulimi duhet të jetë për sasinë e orëve të kërkuara dhe për njësi.*

Pretendimi i OE SFK ishte se OE fitues Commando, me çmimin e ofruar nuk mund ta mbulojë as pagën minimale prej 130 euro. Eksperti shqyrtues Bujar Sopi thotë se kriteri vlerësimit ka qenë “oferta e përgjegjshme me çmimin më të ulët”. Eksperti megjithatë llogarit shpenzimet që do t’i kishte një OE, por duke llogaritur vetëm pagën dhe kontributin e punëdhënësit. Për numrin e punëtorëve që nevojiten, bazohet në fjalët e OE ankues që thotë se nevojiten 15 punëtorë për të kryer këtë shërbim. Pra eksperti nuk bën llogaritje sipas dokumenteve të dosjes së tenderit por bazohet në fjalët e OE ankues. Në fund të llogaritjes eksperti thotë që nuk është llogaritur pagesa shtesë sipas Ligjit të Punës. Në fjalinë e radhës thotë që duke u bazuar në sqarimin më lartë (llogaritjen që e ka bërë) pretendimi për këtë pikë është i pabazuar.

Po të llogariste eksperti shqyrtues edhe shpenzimet për orët e natës do ta shihte që oferta e kompanisë fituese është më e ulët se shpenzimet që do të krijoheshin. Nga llogaritja e pagesës për një orë të natës të bërë më lartë dhe duke pasur parasysh që tenderi është për 36 muaj (që bëjnë 1,095 ditë) dhe në dosje të tenderit janë pesë lokacione ku ka ndërrim të natës atëherë shpenzimi shtesë do të ishte:

$$0.35 * 8 * 1.095 = 3.066 \text{ Euro}$$

për 36 muaj për një roje

$$3,066 * 5 = 15,530$$

Sipas ekspertit shpenzimet e kompanisë fituese janë 73,710 euro, ndërsa oferta e saj është 88,689.74 euro. Kur shpenzimeve të llogaritura nga eksperti i shtohet edhe shuma prej 15,530 euro atëherë shpenzimet janë 89,040 euro. Me këtë

18 OSHP. Vendimi 553/18. 2018. <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/553-18vendim.PDF>

llogaritje shpenzimet e OE fitues tejkalojnë ofertën e tij ende pa u llogaritur pagesat për festa si dhe pushimi vjetor.

Në këtë rast paneli ka marrë vendim kundërthënës me atë për tenderin e Komunës së Gjakovës. Në të dy rastet është kërkuar që të respektohet Ligji i Punës por në vendimin për Komunën e Gjakovës paneli ka vërtetuar dhënien e kontratës, ndërsa në vendimin për Agjencinë Pyjore të Kosovës e ka kthyer tenderin në rivlerësim. Paneli duhet t'i trajtojë njëjtë të gjitha rastet që kanë të bëjnë me respektimin e Ligjit të Punës dhe njëkohësisht të sigurohet që ekspertët shqyrtues dinë të bëjnë llogaritjen e pagës, kontributeve dhe pagesave shtesë.

## Vendimet për nostrifikim të diplomave

Kur një person përfundon studimet jashtë Kosovës atëherë sipas UA 16/2016 të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, neni 3.1 thotë se diploma e tij/saj duhet të nostrifikohet pasi nuk mundet të punojë pa diplomë të nostrifikuar<sup>19</sup>. Paneli në disa vendime merr vendim kundërthënës, ku në një vendim thotë që OE i ka diplomat e stafit të panostrifikuar, ndërsa në vendimet tjera thotë që nostrifikimi i diplomave nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit. Në të gjitha vendimet që OSHP ka marrë, në dosje të tenderit nuk ka qenë kërkesë që diplomat duhet të jenë të nostrifikuar.

### Dorearti & Beni Com, RSM Company, Sinjal & Papenburg v. Ministria e Infrastrukturës, 159-169-173/18

Për tenderin “Sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët Nacionale dhe Rajonale të Republikës së Kosovës”

në OSHP ishin ankuar tri kompani, Dorearti & Beni Com, RSM Company, Sinja & Papenburg. Paneli kishte marrë vendim që tenderi të kthehet në rivlerësim. Eksperti shqyrtues Visar Basha nuk e përmend çështjen e nostrifikimit të diplomave. Në një nga arsyetimet e panelit thuhet që OE fitues Select Prima kishte ofruar diplomë të stafit në gjuhën maqedone dhe gjermane dhe kjo sipas panelit bie ndesh me nenin 13.4 të LPP i cili thotë se dokumentet duhet të jetë në shqip, anglisht ose serbisht. Më tej paneli shton:

*“Ndërsa diplomat e stafit për ta plotësuar kërkesën e AK-së për kapacitete teknike dhe profesionale duhet të jenë të nostrifikuar nga MASHT”*

Të njëjtën gjë paneli e thotë edhe në vendimin 131-132-138-140-143-148/18<sup>20</sup>, ku në faqen 23 të këtij vendimi thuhet:

*“Paneli shqyrtues sqaron se personat të cilët kanë kryer studimet jashtë vendit duhet nostrifikuar diplomat, mirëpo edhe kjo çështje ka mundur të sqarohet sipas nenit 72 të LPP-së.”*

Paneli merr vendim kundërthënës, krahasuar me arsyetimet më lartë pasi në vendimin 248/18<sup>21</sup> vërteton dhënien e kontratës. Pikën ankimore që kishte të bënte me nostrifikim

19 Ministria e Arsimit. UA 16/2016 Parimet dhe Procedurat e Njohjes së Diplomave, Gradave dhe Kualifikimeve të Shkollave të Larta Profesionale dhe Universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës. 2016 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/09/16-ua-masht-16-2016-per-proc-e-njohjeve-te-dip-rotated.pdf>

20 OSHP. Vendimi 131-132-138-140-143-148/18. 2018 <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/131-132-138-140-143-148-18-vend.pdf>

21 OSHP. Vendimi 248/18. 2018 <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/248-18%20vend.pdf>



e diplomave paneli e cilëson si të pabazuar pasi thotë se nostrifikimi i diplomave nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit. Paneli vendimin e arsyeton sipas nenit 56.3 të LPP-së i cili thotë se një ofertues nuk mund të eliminohet për kërkesa që nuk janë në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë. Të njëjtin arsyetim e kishte dhënë edhe eksperti shqyrtues, Abdurrahman Çunaku.

Paneli duhet t'i trajtojë njëjtë të gjitha rastet kur pikë ankimore është nostrifikimi i diplomave. Jokonsistenca e vendimeve më lartë mund të përdoret nga OE si precedent në ankesat në të ardhmen.

## Vendimet për vërtetimin se kompanitë nuk kanë borxhe ndaj ATK-së

Kur AK e zgjedh një fitues, para nënshkrimit të kontratës një nga dokumentet që duhet dorëzuar është vërtetimi i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) për të vërtetuar se një OE nuk ka borxhe ndaj ATK-së.

### Astraplan v. Ministria e Punëve të Brendshme, 130/17

Kundër vendimit për dhënie të kontratës, ankesë në OSHP kishte bërë Astraplan, me arsyen se OE fitues, Mercom Company kishte borxhe ndaj ATK-së. Eksperti shqyrtues, Visar Bibaj, rekomandon që tenderi të kthehet në rivlerësim pasi OE fitues kishte dorëzuar vërtetim të ATK-së që ka marrëveshje për shlyerje të borxheve më këste, por vërtetimi e kishte datën pas hapjes së ofertave. Është e vërtetë që ky vërtetim kërkohet vetëm nga fituesi i cili zgjedhet pasi të hapen ofertat, por prapë çdo dokument në këtë rast duhet të jetë me datë para hapjes së ofertave. Në këtë tender AK kishte kërkuar vërtetim që OE nuk është në vonesë të pagesës së tatimit për tremujorin e fundit para publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës.

Paneli merr vendim që tenderi të kthehet në rivlerësim<sup>22</sup>. Në arsyetim të vendimit, paneli citon nenin 65.4.8 të LPP-së i cili thotë:

4. *Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik*

4.8. *aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar të jetë jo i rëndësishëm në Kosovë.*

Paneli gjithashtu cek që OE fitues ka dorëzuar marrëveshjen për shlyerje të borxheve ndaj ATK-së, por kjo marrëveshje është me datë pas hapjes së ofertave. Siç vërehet nga ky vendim OSHP bënë dy konstatime me rëndësi, e para OE fitues nuk mund të dorëzojë marrëveshje për shlyerjen e borxheve ndaj ATK-së por vërtetim se nuk ka borxhe ndaj saj, si dhe data e këtij vendimi duhet të jetë para hapjes së ofertave.

### Olti Trasing & Alba Group v. Ministria e Punëve të Brendshme, 391/18

OSHP merr një vendim jokonsistent krahasuar me vendimin 130/17 pasi tani kthen në rivlerësim tenderin duke aprovuar ankesën e Olti Trasing, i cili ishte eliminuar për shkak që nuk

<sup>22</sup> OSHP. Vendimi 130/17. 2017  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2017/130-17vend.pdf>



kishte sjellë vërtetimin që nuk kishte borxhe ndaj ATK-së për tremujorin e fundit të periudhës para njoftimit për dhënie të kontratës<sup>23</sup>. AK në fakt e kishte shpallur si fitues konzorciumin Olti Trasing & Alba Group, me çka edhe e kishte ftuar për të nënshkruar kontratën. Anëtar i konzorciumit kishte sjellë vërtetimin e ATK-së, i cili kishte vërejtje që ky OE kishte borxhe. Sipas nenit 71.4 që flet për konzorciume, kërkesat e përshtatshmërisë ku bën pjesë edhe vërtetimi i ATK-së, aplikohen për të gjithë anëtarët e grupit. Pasi Alba Group e kishte vërtetimin që kishte borxhe dhe nuk kishte ndonjë marrëveshje për shlyerje të borxhit me këste, AK kishte vazhduar duke shpallë si fitues OE e dytë me çmimin më të ulët.

Paneli në arsyetim të vendimit thotë që AK duhet të kërkojë sqarime sipas nenit 72 dhe merr parasysh që OE ankues ka çmim më të lirë. Ky vendim është jokonsistent me vendimin 130/17 pasi në atë vendim paneli kishte thënë që OE fitues nuk mund të sjellë marrëveshje për shlyerje të borxheve ndaj ATK me datë pas hapjes së ofertave. Marrëveshja për shlyerje të borxheve nënkupton që OE kishte borxhe ndaj ATK-së dhe nuk ka mundur të sjellë vërtetim që nuk ka borxhe e të jetë me datë para hapjes së ofertave. Në vendimin 391/18 paneli thotë që të kërkojnë sqarime, që në këtë rast nënkupton që anëtar i konzorciumit do të sjellë një marrëveshje për shlyerje të borxhit ndaj ATK-së i cili do të ishte me datë pas hapjes së ofertave. Paneli thotë gjithashtu që OE ankues është më i lirë se OE fitues si dhe AK duhet ta ketë parasysh qëllimin e prokurimit dhe të sigurohen që fondet publike do të shpenzohen në mënyrë më ekonomike. Për këtë tender oferta e Olti Trasing & Alba Group ishte më e lirë për 21,660.02 euro se oferta e OE fitues, Euroing. Por paneli në vendimin 130/17 nuk e kishte thënë që fondet publike duhet të shpenzohen në mënyrë më ekonomike, pasi në atë rast oferta e OE fitues, Mercom Company ishte për 57,742.8 euro më e lirë se oferta e OE ankues.

Eksperti shqyrtues, Hasim Krasniqi, për këtë rast kishte dhënë rekomandim që ankesa të refuzohet pasi Alba Group kishte dështuar të sjellë vërtetimin që nuk kishte borxhe ndaj ATK-

së. Për të mbështetur rekomandimin eksperti ishte bazuar në nenin 65.4.8 të LPP-së dhe nenin 26.8 të Udhëzuesit.

Me këtë vendim të OSHP-së, problemi është që sipas nenit 65.4.8 të cilin paneli e kishte cituar në vendimin 130/17, një OE nuk ka të drejtë as të marrë pjesë në tender nëse ka borxhe ndaj ATK-së. AK në këtë rast kishte vepruar edhe sipas Udhëzuesit i cili sipas nenit 26.8 në faqe 61-62 thotë që nëse një OE shpallet fitues dhe dështon të sjellë vërtetimet që kërkojnë në kërkesat e përshtatshmërisë (këtu bën pjesë edhe vërtetimi i ATK-së), tenderi i tij do të refuzohet, do të konfiskohet sigurimi i tenderit si dhe AK do të iniciojë procedurën për diskualifikim (futje në listë të zezë) sipas nenit 99.2 të LPP-së<sup>24</sup>. Në këtë rast, AK vetëm ka vazhduar me ofertuesin e dytë por nuk ka kërkuar që të ketë procedurë për diskualifikim. Paneli në rastet kur një OE dështon të sjellë vërtetimin që nuk ka borxhe ndaj ATK-së duhet të vendosë gjithmonë kundër OE, pasi borxhi ndaj ATK-së nënkupton që një OE nuk është duke paguar me rregull tatimin e tij, dhe kjo është një shkelje serioze që e parasheh edhe LPP, i cili nuk lejon një OE as të ofertojë nëse ka borxhe.

Pas rivlerësimit, AK zgjodhi fitues përsëri OE e njëjtë, Euroing. Pas këtij vendimi përsëri në OSHP u ankua Olti Trasing & Alba Group. AK gjatë procedurës së rivlerësimit i kishte kërkuar sqarime Alba Group dhe kishte kërkuar që të sjellë vërtetimin se nuk ka borxhe ndaj ATK-së, por që ky vërtetim të jetë me datë para 4 korrikut 2018. Kjo datë ishte pas hapjes së ofertës por para njoftimit për dhënie të kontratës. Eksperti shqyrtues thotë që AK nuk mund të caktojë një datë fikse, por është dashur që të veprojë sipas kërkesës që OE fitues të dorëzojë vërtetimin e ATK-së para publikimit për dhënie të kontratës. Këtë kërkesë në fakt Alba Group kishte dështuar ta plotësonte pikërisht para njoftimit për dhënie të kontratës. Alba Group kishte dorëzuar vërtetimin që ka marrëveshje për shlyerje të borxhit me këste më 1 tetor 2018, të cilin e kishte nxjerrë më 31 gusht 2018. Mirëpo, eksperti duke cituar vendimin e kaluar si dhe duke pasur parasysh që OE ankues kishte ofertë më të ulët, rekomandon që tenderi të kthehet në rivlerësim.

23 OSHP. Vendimi 391/18. 2018  
[https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/391-18vendim\\_1.PDF](https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/391-18vendim_1.PDF)

24 Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik. 2017  
<https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/2018/04/rroopp13042018.pdf>

Paneli duke u bazuar në sqarimet e ekspertit thotë se oferta e OE ankues është më e lirë për 21,660.02 euro. Paneli thotë që AK nuk mund të caktojë datë fikse se me çfarë date duhet të jetë vërtetimi i ATK-së. Paneli këtë e interpreton që AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së i cili thotë që një OE nuk mund të eliminohet për një kriter ose kërkesë që nuk është kërkuar në dosje të tenderit. Në dosje të tenderit është kërkuar që vërtetimi të jetë pa borxhe dhe ai duhet të dorëzohet para publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës. Sipas nenit 26.8 të Udhëzuesit, OE i shpallur fitues ka afat pesë ditë që të sjellë dokumentet e kërkuara në kërkesat e përshtatshmërisë. Në këtë rast Alba Group e ka tejkaluar dukshëm afatin prej pesë ditësh, pasi OE si fitues ishte zgjedhur në fillim të muajit korrik 2018, ndërsa vërtetimin e ATK-së e kishte dorëzuar më 1 tetor 2018. Duke u bazuar në këto arsyeime paneli përsëri ktheu tenderin në rivlerësim<sup>25</sup>.

Pas rivlerësimit AK anulon tenderin me arsyen:

*Nga Departamenti i Prokurimit nuk ka qenë e mundur të zbatohet vendimi për rivlerësim i OSHP-së nr. 578/18, sepse AME nuk ka formuar komisionin e Rivlerësimit të ofertave dhe për këtë është njoftuar OSHP-ja nga AK-MPB, prandaj bëhet anulimi i procedurës së prokurimit publik për këtë aktivitet të prokurimit.*

Deri më 25 janar 2018 nuk kishte ndonjë ankesë të re në OSHP lidhur me këtë tender.

Në dy vendimet më lartë paneli merr vendim jokonsistent. Në vendimin 130/17 paneli me të drejtë bazohet në nenin 65.4.8 të LPP-së. Në këtë nen do të duhej të bazohej edhe në vendimin 391/18 pasi mosvonesa në pagesë të tatimit është kusht për pjesëmarrje në tender. Nëse një OE arrin të zgjedhet fitues me borxhe ndaj ATK-së atëherë kjo është shkelje e nenit 65.4.8 të LPP-së.

## Vendimet për ankesat në kriteret të dosjes së tenderit

Shpesh ndodh që AK gjatë hartimit të dosjes së tenderit të vendosin kriteret që janë favorizuese për një prodhues të caktuar, ose në rastin më të keq kërkojnë produkt specifik të një prodhuesi pa e shtuar fjalën "ekuivalent". Ankesat ndaj kriterëve të dosjes së tenderit duhet të bëhen së paku pesë ditë para hapjes së ofertave, siç e përcakton neni 108/A i LPP-së.

### Carpet v. Kuvendi i Kosovës, 14/18

Kompania Carpet ishte ankuar në OSHP kundër vendimit që Kuvendi i Kosovës kishte marrë për t'i dhënë kontratën kompanisë Gjini. Carpet pretendonte që specifikat teknike të dosjes së tenderit ju ishin përshtatur kompanisë Gjini 100%. Këtë pretendim Carpet e mbështeste në nenin 28 të LPP-së i cili thotë se ndalohej që AK të hartojë specifikat të cilat favorizojnë ndonjë prodhues të caktuar. AK këtë mund ta

bëjë vetëm nëse shton edhe fjalën "ekuivalent". Eksperti shqyrtues Visar Basha thotë se Carpet për këtë është dashur të bëjë ankesë para hapjes së ofertave, bazuar në nenin 108/A të LPP-së. Eksperti nuk merret fare me pretendimin ankimor për përshtatje të kriterëve, por vetëm rekomandon refuzimin e ankesës.

Me mendimin e ekspertit pajtohet edhe paneli i cili merr vendim të refuzohet ankesa, pasi thotë se për ankesë në kriteret, Carpet është dashur që këtë ta bëjë para hapjes së ofertave<sup>26</sup>. Me këtë vendim OSHP vendos standardin e mos trajtimit të ankesave kundër specifikave teknike të tenderit nëse ato nuk janë bërë brenda afatit ligjor prej pesë ditë para hapjes së ofertave. Siç do të lexoni më poshtë, ky vendim është në kundërshtim me precedentin e më vonshëm të OSHP-së.

<sup>25</sup> OSHP. Vendimi 578/18. 2018  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/578-18vend.pdf>

<sup>26</sup> OSHP. Vendimi 14/18. 2018  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/14-18vendim.pdf>

## DWH Kosova v. Komuna e Gjilanit, 241/18

Në ankesën e DWH Kosova kundër vendimit që Komuna e Gjilanit të shpërblejë me kontratë OE Ageo-co, paneli kishte marrë vendim jokonsistent me vendimin 14/18 pasi kishte vendosur që tenderi të anulohet<sup>27</sup>. DWH Kosova ishte ankuar për kriteret e dosjes së tenderit me arsyen që specifikat teknike kanë qenë të përshtatura për një kompani, por këtë e kishte bërë pas hapjes së ofertave e pasi ishte zgjedhur fitues kompania Ageo-co.

Eksperti Abdurrahman Çunaku rekomandon që tenderi të anulohet pasi AK në specifika kishte kërkuar/përdorur emër të

një prodhuesi, e sipas tij kjo bie ndesh me nenin 27.8 të LPP-së. AK pranon që në pozicionin për bateri kanë kërkuar emër të prodhuesit, por pasi vetëm ajo bateri e plotëson pajisjen që AK ishte duke e përdorur. Paneli në arsyetim të vendimit thotë se është shkelur neni 27.8 i LPP-së, i cili në fakt nuk është shkelur në këtë rast pasi nuk mundet një bateri e një prodhuesi tjetër të përshtatet me pajisjen që komuna ishte duke e përdorur. Megjithatë, paneli po të përdorte arsyetimin sipas nenit 108/A do të duhej që ta vërtetonte vendimin e AK për dhënie të kontratës pasi DWH Kosova nuk ishte ankuar në kriteret para hapjes së ofertave.

## Vendimet për Prokurimet “Brenda shtëpisë”

Në vitin 2017 komuna e Gjakovës kishte publikuar tenderin “Shërbime të telefonisë mobile për komunën e Gjakovës”. Pas hapjes së ofertave ishte ankuar Telekom i Kosovës me pretendimin që është shkelur neni 9.4 i LPP-së. Interpretimi i bërë nga KRPP për nenin 9.4 dhe i publikuar tek pyetjet e shpeshta thotë:<sup>28</sup>

36. Duke marr për bazë dilemat e shfaqura të Autoriteteve Kontraktuese dhe, kërkesat e shumta të tyre (drejtuar KRPP-ës) që të bëhet e qartë se si duhet të vepohet në rastet kur një Autoritet Kontraktues (Autoritet Publik) ka nevojë për sigurim të shërbimeve të cilat i posedon një Autoritet tjetër po ashtu publik?

*Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t’u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik”. Pra neni i lartë cituar rregullon rastet kur Autoriteti Kontraktues (Autoriteti Publik) ka nevojë për sigurimin e shërbimeve operator i të cilave po ashtu është një autoritet publik. LPP, nuk e sqaron me tej se si autoritet*

*publike do të rregullojnë plotësimin e nevojave të tyre (në mes vete) meqë kjo është çështje e autoriteteve publike dhe/ose rregullave tjera. Mirëpo është mëse e qartë se këto raste kanë të bëjnë me përjashtimet nga zbatimi i legjislacionit që rregullon prokurimin publik kur një formë e partneritetit publiko privat realizohet (një AK mund të kërkojë ofrimin e një shërbimi në shërbimet e tij ose shërbimeve të një autoriteti tjetër kontraktues pa inicuar ndonjë procedurë tenderimi, të ashtuquajtura përjashtim “në shtëpi”). Si përfundim pas analizimit të cekur më lartë (neni 9.4 të LPP-së) dhe të kërkesave tuaja, meqë nuk ka asnjë dispozitë tjetër të LPP-ës e cila i obligon Autoritetet Publike që të marrin masa për të mos lejuar “shtrembërimin e konkurrencës” (sikur ato nga direktiva e BE-së, neni 12.1) KRPP nuk ka se si të mos e trajtojë këtë çështje ashtu sikur është vendosur në nenin 9.4 të LPP-së.*

27 OSHP. Vendimi 14/18. 2018  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/14-18vendim.pdf>

28 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Pyetjet e Shpeshta Nr. 36. 2017  
[https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=HelpInfo&LID=1&PPRCMenu\\_OpenNode=109](https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=HelpInfo&LID=1&PPRCMenu_OpenNode=109)

Ky interpretim nënkupton që nëse një shërbim ofrohet nga një autoritet publik, në këtë rast Telekom i ofron shërbime të telefonisë mobile, atëherë të gjitha autoritetet tjera publike duhet të marrin këto shërbime nga Telekom. Në këtë rast pasi komuna e Gjakovës është autoritet publik dhe Telekom është autoritet publik që ofron shërbime të telefonisë mobile, kontrata duhet t'i jepet Telekomit.

Komuna refuzon kërkesën për rishqyrtim të bërë nga Telekom, i cili më pas ankohet në OSHP. Eksperti shqyrtues rekomandon që ankesa e Telekomit të aprovohet për arsye që është shkëlur neni 9.4. Paneli vendosë që ankesa e Telekomit të refuzohet me arsyetimin që nuk është ankuar para hapjes së tenderëve<sup>29</sup>.

Për një tender tjetër OSHP merr vendim jokonsistent me vendimin më lartë pasi lejon komunën e Ferizajt që të anulohet tenderin pas hapjes së ofertave, në mënyrë që të lidhet kontratë me kompaninë e komunës sipas nenit 9.4. Komuna e Ferizajt kishte shpallur tender për "Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve gjatë sezonit veror dhe dimëror". Fitues ishte rekomanduar OE Rahovica. Kundër këtij vendimi në OSHP kishte parashtruar ankesë OE El-Bau. Pretendimet e El-Bau nuk lidheshin me nenin 9.4 por për disa nene tjera që nuk ishin respektuar. Paneli duke u bazuar edhe në rekomandimin e ekspertit vendosi që tenderi të kthehet në rivlerësim<sup>30</sup>.

Komuna pasi kryen rivlerësimin vendos që tenderi të anulohet në mungesë të ofertave të përgjegjshme. El Bau përsëri bën ankesë në OSHP me pretendimin që është shkëlur neni 62 i LPP-së i cili parashesh se kur tenderi mund të anulohet. Eksperti Hasim Krasniqi kishte kërkuar sqarime nga komuna për pretendimin që ka gabime në paramasë, por e cila nuk kishte dhënë shpjegime bindëse. Në përgjigjen që komuna ia kishte dërguar ekspertit thuhet se zyra e prokurimit dhe Kryetari i Komunës në konsultim me departamentin e rregullave pranë KRPP-së dhe në përputhje me nenin 9.4 kanë vendosur të angazhojnë kompaninë lokale KRM Pastërtia për mirëmbajtje verore, ndërsa për mirëmbajtje dimërore të vazhdojnë me procedurën e prokurimit. Eksperti rekoman-

don që tenderi të kthehet në rivlerësim për arsye që ai nuk mund të anulohet për gabime në paramasë që i ka bërë AK. Paneli mbështet vendimin e Komunës duke vërtetuar vendimin për anulimin e tenderit<sup>31</sup>. Arsyetimi i panelit është që komuna do të lidhë kontratë me KRM Pastërtia e cila është ndërmarrje publike ku komuna ka pronësi.

Në këtë vendim problemi qëndron se komuna ka qenë e vetëdijshme që e ka kompaninë e vet dhe ka mundur të lidhë kontratë direkt pa nisur fare procedura të prokurimit. Për më tepër, po të mos ishte ankesa e El-Bau komuna do të lidhte kontratë me OE Rahovica. Në vendimin e parë paneli kishte vendosur që tenderi të kthehet në rivlerësim. Rivlerësimi nuk nënkupton që tenderi të anulohet. Ky vendim i OSHP-së është kundërthënës me vendimin për komunën e Gjakovës pasi aty tenderi nuk është anuluar pasi janë hapë ofertat edhe pse shkelja e supozuar e nenit 9.4 do të ndodhte. Ndërsa në tenderin e komunës se Ferizajt tenderi anulohet pasi janë hapur ofertat me arsyetimin se do të shfrytëzohet neni 9.4 për të lidhur kontratë me kompaninë e komunës. Komuna me këtë rast ka shkëlur precedentin e vendosur paraprakisht me Komunën e Gjakovës.

29 OSHP. Vendimi 13/17. 2017  
[https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2017/13-17vendim\\_1.PDF](https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2017/13-17vendim_1.PDF)

30 OSHP. Vendimi 12/18. 2018  
[https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2017/13-17vendim\\_1.PDF](https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2017/13-17vendim_1.PDF)

31 OSHP. Vendimi 194/18. 2018  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/194-18vend.pdf>

## Vendimet për nenin 61 – tender jonormalisht i ulët

Vendime jo konsistente janë identifikuar edhe për tenderët jo normalisht të ulët, të cilët janë shumë të shpeshtë në aktivitetet e prokurimit publik. Çështja kontestuese në këtë rast mbetet se a lëshohet ose jo OSHP në vlerësimin e çmimeve nëse janë në përputhje me ato të tregut. Apo nëse kjo gjë është përgjegjësi e AK e cila përmes Nenit 61 duhet të kërkojë sqarime dhe të shoh nëse çmimi është në përputhje me vlerën e tregut dhe nëse kontrata mund të zbatohet pa probleme. Pra çështja esenciale në këtë rast është se si trajtohen rastet kur AK ka kërkuar sqarime dhe është bindur se kontrata mund të zbatohet edhe me çmimet të cilat fillimisht janë dukur si jo normalisht të ulëta, nëse i besohet ose jo këtij vendimit të AK-së. Deri më tani OSHP nuk ka krijuar standard, as në nivel të ekspertëve dhe as në panele shqyrtuese. Siç do të sqarohet në rastet e më poshtme OSHP ka më shumë se një standard në trajtimin e kësaj çështje.

### Auto Beka v. Gjykata Themelore Ferizaj, 202/18

OE Auto Beka është ankuar në OSHP kundër njoftimit për dhënie të kontratës të bërë nga Gjykata Themelore Ferizaj për tenderin “Servisimi, mirëmbajtja dhe pastrimi i automjeteve”. Auto Beka është ankuar pasi OE i rekomanduar për kontratë Universal Commerce ka ofruar çmime jonormalisht të ulëta. AK thotë se i ka kërkuar sqarime kompanisë fituese në bazë të nenit 61 të LPP-së dhe është bindur nga përgjigja që ka dhënë OE. OSHP refuzon ankesën dhe merr vendim në përputhje me rekomandimin e ekspertit shqyrtues duke thënë që AK i ka respektuar procedurat sipas nenit 61 dhe rregulloren për tenderë jonormalisht të ulët<sup>32</sup>.

### Vlora v. Komuna e Shtimes, 188/18

Vendimi tjetër që ka të bëjë me të njëjtin nen është marrë më 7 qershor 2018. Vendimi është që të aprovohet pjesërisht ankesa e kompanisë Vlora, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim<sup>33</sup>. Pretendimet ankimore të OE Vlora janë që OE i rekomanduar për kontratë Star-Graf ka ofertuar me çmime jonormalisht të ulëta. Komuna e Shtimes ka kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar dhe është bindur nga sqarimet e tyre. Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor AK thotë që i kemi respektuar procedurat sipas nenit 61. Eksperti shqyrtues nuk bindet nga përgjigja që ka dhënë Star-Graf dhe rekomandon që ankesa të aprovohet ndërsa lënda të kthehet në rivlerësim. Paneli shqyrtues mbështet rekomandimin e ekspertit, ndërsa vendimin e arsyeton duke thënë që “autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 61 të LPP-së kur ka rekomanduar për dhënie të kontratës një operator ekonomik i cili ka ofertuar me çmime që nuk janë reale me vlerën e tregut”.

### Global Parajsa, Shqiponja v. Kuvendi i Kosovës, 26-27/18

Paneli i OSHP-së në një vendim tjetër, 26-27/18<sup>34</sup>, në arsyetim thotë:

*“Autoriteti kontraktues vetë vlerëson nëse një tender është jonormalisht i ulët, prandaj e drejta dhe përgjegjësia bie mbi autoritetin kontraktues për të trajtuar një tender apo pozicion të tenderit si jonormalisht të ulët.”*

32 OSHP. Vendimi 202/18. 2018  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/202-18vend.pdf>

33 OSHP. Vendimi 188/18. 2018  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/188-18vendim.pdf>

34 OSHP. Vendimi 26-27/18. 2018.  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/26-27-18vendim.pdf>

Dy vendimet më lartë, njëri për Gjykatën Themelore të Ferizajit dhe tjetri për komunën e Shtimes janë jokonsistent. Në vendimin për Gjykatën Themelore paneli merr parasysh faktin se AK është bindur nga sqarimi i kompanisë fituese. Ndërsa në vendimin për komunën e Shtimes nuk merr parasysh arsyetimin e AK, i cili njëjtë thotë që është bindur në

arsyetimin e kompanisë fituese. Po të përdorej arsyetimi i OSHP-së që AK vetë vlerëson nëse një tender është jonormalisht i ulët atëherë, në tenderin e komunës së Shtimes do të fitonte kompania Star Graf, pasi komuna ishte bindur në arsyetimin e kompanisë për tenderin me çmim jonormalisht të ulët.

## Vendimet mbi përdorimin e formulës për llogaritje të tenderit jonormalisht të ulët

### Promix v. KEK, 204/18

Në tenderin furnizim me material për zyrë të iniciuar nga KEK, kompania Promix ishte eliminuar pasi nga 141 artikuj, në 76 prej tyre kishte ofruar çmim 0.01 euro. KEK i kishte kërkuar sqarime për këto çmime, ndërsa Promix ishte përgjigjur se qëndron prapa çmimeve të ofruara pa dhënë detaje në lidhje me koston e produktit, fitimin e planifikuar, etj. Pas eliminimit, Promix bën ankesë në OSHP. Eksperti, Xhevdet Bushi thotë se pasi dallimi në mes të ofertës së ankuesit dhe të fituesit është vetëm 9,036.68 euro, atëherë të përdoret formula nga KRPP për të llogaritur se a përmbushen kushtet për t'u trajtuar si ofertë me çmim jonormalisht të ulët. Gjithashtu ai propozon që pasi oferta e ankuesit është me çmim më të ulët, atëherë në rast të dyshimeve mund të rritet shuma e sigurisë së ekzekutimit. Paneli nuk pajtohet me rekomandimin e ekspertit dhe vendos që të vërtetohet vendimi për dhënie të kontratës për kompaninë fituese, Grafo-Loni<sup>35</sup>. Në arsyetim paneli thotë që AK i ka ndjekur të gjitha procedurat sipas nenit 61.

### Shqiponja v. KRU Prishtina, 285/18

Në tenderin për shërbime të gastronomisë të iniciuar nga Kompania Regjionale e Ujësjellësit Prishtina (KRU Prishtina), paneli vendos ndryshe. KRU Prishtina kishte shpallë të papërgjegjshme kompaninë Shqiponja pasi kishte ofruar

çmime jonormalisht të ulëta. AK i kishte kërkuar sqarime kompanisë për disa pozicione ku kishte dhënë çmime jonormalisht të ulëta. Shqiponja nuk ishte përgjigjur në kërkesën për sqarim, ndërsa KRU Prishtina e kishte eliminuar si të papërgjegjshëm. Në këtë rast edhe pse çmimet në dukje janë jonormalisht të ulëta, AK kishte përdorur formulën për llogaritje të çmimeve jonormalisht të ulët për 6 pozicione të paramasës e jo për të gjithë tenderin, duke krahasuar çmimin mesatar të nxjerrë nga ofertuesit tjerë. Shqiponja e pakënaqur me vendimin e KRU Prishtina, bën ankesë në OSHP me pretendimin se nuk është respektuar rregullorja për tenderët jonormalisht të ulët (Rregullorja B57 e KRPP-së). Eksperti Visar Basha konstaton se AK ka respektuar procedurat e nenit 61 dhe me të drejtë e ka eliminuar OE Shqiponja. Ai gjithashtu thotë që në përputhje me nenin 61, vlerësimi i çmimeve është e drejtë e autoritetit kontraktues. Paneli merr vendim që tenderi të kthehet në rivlerësim pasi AK nuk ka vepruar në pajtim me Rregullat për tender jonormalisht të ulët, B57 dhe nenin 61.

Këto dy vendime të OSHP-së janë kundërtë nëse në mes vete. Në të dy tenderët, autoriteti kontraktues ka eliminuar kompanitë për tender jonormalisht të ulët, por pa e përdorur formulën sipas Rregullores B57. Në vendimin për tenderin e KEK-ut, OSHP thotë se është bërë në përputhje me nenin 61, ndërsa në tenderin e KRU Prishtina thotë se nuk është bërë në pajtim me nenin 61. Në të dy rastet ekspertët kanë qenë të ndryshëm. Në tenderin e KEK-ut eksperti e përmend

35 OSHP. Vendimi 204/18. 2018  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/204-18vendim.pdf>

formulën sipas rregullores B57, ndërsa paneli vendos ndryshe duke thënë që është respektuar neni 61. Në tenderin e KRU Prishtina, eksperti se përmend formulën për llogaritjen e tenderit jonormalisht të ulët, mirëpo paneli në arsyetim thotë që kjo formulë nuk është përdorur. Për të dyja rastet,

po të përdorej formula asnjëri nga tenderët në tërësi nuk do të cilësohej si jonormalisht i ulët pasi ofertat e kompanive tjera janë shumë afër me çmim. Paneli duhet të sigurohet që të përdor kritere të njëjta në lidhje me përdorimin e formulës për llogaritje të tenderit jonormalisht të ulët.

## Librezat e automjeteve me regjistrim të skaduar

Në shumë vendime dhe tender që D+ ka analizuar ka vërejtur se shumë OE nuk i ofrojnë librezat e pajisjeve të tyre valide. Kjo ndodhë ndoshta për shumë arsye, por kryesorja është që bizneset dëshirojnë të kursejnë duke mos regjistruar automjetet që i kanë në pronësi dhe që nuk i kanë në përdorim gjatë kohës sa nuk kanë kontrata aktive. Në momentin që ato fitojnë ndonjë tender dhe ju nevojiten automjetet, atëherë i regjistrojnë. Mosvazhdimi i regjistrimit të automjetit lejohet edhe me Ligjin për Automjete, por me kusht që ta ç'lajmërojnë automjetin, që nënkupton që duhet t'i dorëzojë tabelat në qendrën e regjistrimit të automjeteve. Megjithatë kusht për pjesëmarrje në komunikacion është që automjeti të ketë regjistrim valid<sup>36</sup>. Një nga kërkesat e shpeshta në dosje të tenderit është që për automjetet që kërkohen si dëshmi të dorëzohet librezat. Edhe për këtë çështje D+ ka hasur në vendime të cilat nuk janë të harmonizuara.

regjistrimit të skaduar para dorëzimit të ofertave. Për këtë pikë, eksperti shqyrtues Basri Fazliu deklaroi se nuk është kërkuar në dosje të tenderit që librezat të kenë regjistrim. Mendim të tillë ka edhe paneli i cili shton që edhe po të kërkoheshin që librezat të kenë regjistrim, kjo nuk mund të jetë kriter për eliminim.<sup>37</sup>

## Aome & Diari v. Komuna e Klinës, 668/18

Në vendimin 668/18<sup>38</sup> paneli thotë që OE fitues, Agoniti ka dorëzuar një librezë për një kamion e cila e kishte regjistrimin e skaduar. Kërkesa në dosje të tenderit ishte e njëjtë me atë të Komunës së Mitrovicës, automjetet duhet të dëshmojnë përmes librezave. Të njëjtin mendim me panelin e ka edhe ekspertja shqyrtuese Es'hema Beka.

Janë dy vendime ku për një kërkesë identike, paneli mendon ndryshe duke krijuar një jokonsistencë e cila mund të përdoret nga OE në të ardhmen si precedent, kur ka një kërkesë të tillë në dosje të tenderit.

## R&Rukolli, Bajraktari v. Komuna e Mitrovicës, 476-478/18

Një nga kërkesat e Komunës së Mitrovicës për të cilën e kishte eliminuar kompaninë Bajraktari ishte se nuk kishte dorëzuar librezat me validitet të regjistrimit. Në dosje të tenderit një nga kërkesat ishte që automjetet të dëshmojnë përmes librezave për qarkullim. Bajraktari ishte eliminuar për shkak që librezat që kishte dorëzuar e kishin afatin e

36 Ligji Nr. 05/L-132 për Automjete. Neni 39.1 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. 2017 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14671>

37 OSHP. Vendimi 476-478/18. 2018 <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/476-478-18vendim.pdf>

38 OSHP. Vendimi 668/18. 2018 <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/668-18%20vend.pdf>



## Vendimet për mosplotësim të formularit për dorëzim të tenderit

Formulari për dorëzim të tenderit (pjesa C në dosje të tenderit) është dokumenti kryesor që një OE duhet ta plotësojë, në mënyrë që një OE të cilësohet i përgjegjshëm. OSHP në dy raste, ka marrë vendime jokonsistente ku në njërin vendim mosplotësimin e një pikë në këtë formular e ka cilësuar devijim të vogël e në vendimin tjetër e ka cilësuar se OE nuk e ka plotësuar si duhet këtë formular.

### Blendi v. Komuna e Suharekës, 408/18

Një nga pikat për të cilat ishte ankuar OE Blendi ishte që OE fitues nuk e kishte plotësuar pikën gjashtë të formularit për dorëzim të tenderit. Pika gjashtë thotë se OE duhet të shënojë nacionalitetin e vet dhe të nënkontraktuesit, nëse ka. Eksperti shqyrtues e ngatërron këtë dhe thotë që kjo pikë është vetëm për nënkontraktuesin e jo edhe për OE fitues, i cili në këtë tender kishte ofertuar i vetëm. Eksperti duke hedhur poshtë edhe pretendimet tjera rekomandon që ankesa të refuzohet. Të njëjtin arsyetim e përdorë edhe paneli i cili vendos që të vërtetohet njoftimi për dhënie të kontratës<sup>39</sup>.

### Blendi v. QKUK, 111/17

Gjatë seancës për ankesën 408/18 kompania Blendi ia përmend panelit se për një çështje të njëjtë në vendimin 111/17 pikërisht kur kjo kompani kishte qenë ankues, paneli kishte vendosur ndryshe duke hedhur poshtë ankesën si të pale-

juar<sup>40</sup>. Blendi në atë tender nuk kishte shënuar emrin e AK dhe titullin e kontratës, e vetëm për këtë pike paneli kishte konstatuar që Blendi me të drejtë është eliminuar. Paneli në vendim citon nenin 18 të Udhëzuesit i cili thotë që nëse formulari për dorëzim të tenderit nuk plotësohet dhe nënshkruhet, nënkuptohet që nuk ka ofertë<sup>41</sup>.

### Mobelland v. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, 624/18

Për një shkelje më të rëndë që OE Mobelland e kishte bërë, paneli kishte aprovuar ankesën dhe kishte kthyer tenderin në rivlerësim<sup>42</sup>. Mobelland nuk kishte shënuar emrin dhe adresën e anëtarit të konzorciumit, të cilin paneli e kishte cilësuar si devijim të vogël, sipas nenit 59.4 të LPP-së. Ky vendim përveç që është jokonsistent me vendimet më lartë, është edhe jokonsistent me vendimin paraprak për këtë tender.

Në vendimin 407-433/18<sup>43</sup> për ankesat e Mobelland dhe Metalit paneli kishte kthyer tenderin në rivlerësim duke aprovuar pikat ankimore të Metalit. Ndërsa për Mobelland e kishte aprovuar vetëm pikën ankimore për të cilën Mobelland ishte ankuar që AK nuk kishte pezulluar aktivitetin e prokurimit kur ishte bërë ankesa. Pikën tjetër, paneli e kishte cilësuar si të pabazuar duke theksuar që Mobelland është cilësuar i përgjegjshëm pasi nuk kishte shënuar emrin dhe adresën e anëtarit të konzorciumit. Paneli bazohet gabimisht në nenin

39 OSHP. Vendimi 408/18. 2018  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/408-18vend.pdf>

40 OSHP. Vendimi 111/17. 2017  
[http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2017/111-17vendim\\_1.PDF](http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2017/111-17vendim_1.PDF)

41 Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik. Neni 18. 2016  
[https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/STRforms2016/Shqip/A01\\_Rregullat%20dhe%20Udhëzuesi%20operativ%20per%20Prokurimin%20Publik.pdf](https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/STRforms2016/Shqip/A01_Rregullat%20dhe%20Udhëzuesi%20operativ%20per%20Prokurimin%20Publik.pdf)

Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik. Neni 18. 2016  
[https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/STRforms2016/Shqip/A01\\_Rregullat%20dhe%20Udhëzuesi%20operativ%20per%20Prokurimin%20Publik.pdf](https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/STRforms2016/Shqip/A01_Rregullat%20dhe%20Udhëzuesi%20operativ%20per%20Prokurimin%20Publik.pdf)

42 OSHP. Vendimi 624/18. 2018  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/624-18vend.pdf>

43 OSHP. Vendimi 407-433/18. 2018  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/407-433-18vend.pdf>



32.4 të Udhëzuesit i cili flet për dorëzim të ofertës në formë fizike e cila duhet të futet në një zarf e në ballinë të zarfit duhet të shënohet emri dhe adresa e tenderuesit. AK e kishte eliminuar Mobelland që nuk kishte shënuar emrin dhe adresën e anëtarit të konzorciumit në formular për dorëzim të tenderit.

Paneli pra kishte konstatuar që Mobelland me të drejtë është shpallë i papërgjegjshëm në vendimin 407-433/18, ndërsa në vendimin 624/18, për të njëjtën arsye të eliminimit kishte thënë se është devijim i vogël.

## Siguria e tenderit

Dorëzimi i sigurisë së tenderit në kopje fizike ditën e hapjes së ofertave ka qenë po ashtu çështje sfiduese në OSHP. Kontestuese mbetet fakti se a duhet të kërkohet në dosje të tenderit që siguria e tenderit të dorëzohet në kopje fizike edhe pse diçka e tillë është kërkesë e Udhëzuesit.

### Doni Term v. Komuna e Gjilanit, 01/18

Kompania Doni Term ishte ankuar në OSHP pasi OE i rekomanduar për kontratë, Adetex nuk e kishte dorëzuar sigurinë e tenderit në formë fizike, pasi kishte ofertuar në formë elektronike. Eksperti Visar Basha citon nenin 29.13 të Udhëzuesit ku thuhet se nëse tenderi dorëzohet në formë elektronike, atëherë siguria e tenderit duhet të dorëzohet në formë fizike ditën e hapjes së ofertave<sup>44</sup>. Paneli vendos njëjtë me rekomandimin e ekspertit, duke cituar gjithashtu nenin 29.13 të Udhëzuesit dhe vendos që ankesa të aprovohet dhe tenderi të kthehet në rivlerësim<sup>45</sup>.

### Eng Idea & Lorenzo v. Ministria e Infrastrukturës, 160/18.

Në tenderin "Hartimi i projektit zbatues për ndërtimin e autostradës Istog-Deçan-Gjakovë-Prizren", AK një nga arsyet që eliminon konzorciumin Eng Idea & Lorenzo & Co është se nuk e ka dorëzuar sigurinë e tenderit në mënyrë fizike, pasi ky konzorcium kishte ofruar në mënyrë elektronike. Për këtë pikë eksperti Qazim Hoxha edhe pse konstaton çka thotë neni 29.13 i Udhëzuesit, bazohet në fjalët e OE ankues i cili citon një interpretim të KRPP-së të datës 28 gusht 2017 i cili thotë:

*Kërkesa e nenit 29.13 të Rregullave dhe UOPP duhet të vendoset në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.*

Për këtë arsye eksperti rekomandon që, ankesa të aprovohet pasi konzorciumi Eng Idea & Lorenzo & Co nuk mund të eliminohet për këtë pikë. Paneli për këtë pikë jep arsyetimin të njëjtë si eksperti dhe vendos që ankesa të aprovohet dhe tenderi të kthehet në rivlerësim<sup>46</sup>.

Të dy këta tenderë janë iniciuar pas interpretimit të dhënë nga KRPP. Në këtë rast paneli për çështje të njëjtë vendos ndryshe.

44 Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik. Neni 29.13. 2017 <https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/STRforms2017/sq/RREGULLAT%20dhe%20UDHEZUESI%20OPERATIV-01062017.pdf>

45 OSHP. Vendimi 01/18. 2018 <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/01-18vendim.pdf>

46 OSHP. Vendimi 160/18. 2018 <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/160-18vendim.pdf>

## Vendimet jokonsistente për tender të njëjtë

Për disa tenderë në OSHP ka vazhdimisht ankesa, aq sa ka raste kur tenderi kalon më se dy vite në procedura ankimore dhe rivlerësime. Kur është mundësia, si shembull për ndonjë kërkesë të pamatshme, është më mirë që tenderi të anulohet dhe të përmirësohen gabimet. OSHP siç duket nuk i shikon vendimet paraprake për një tender, pasi në një rast AK ka shterur të gjitha mundësitë praktike deri sa vendimi përfundimtar ishte që tenderi të anulohet. Humbja e kohës shkakton pastaj komplikime tjera si në buxhet ose humbje e interesit nga AK që të vazhdojë më tutje aktivitetin.

### Vendimet për tenderin “Asfaltimi i rrugës: Babush-Tërn-Luboc-Koshare-Slivovë”

Kompania Sallahu ishte ankuar kundër vendimit për dhënie të kontratës për tenderin “Asfaltimi i rrugës: Babush-Tërn-Luboc-Koshare-Slivovë”. Fituesi i kontratës ishte zgjedhur kompania Bageri. Ky aktivitet prokurimi ishte një ritender i tenderit të parë, për të cilin edhe D+ kishte shkruar në raportet e kaluara<sup>47</sup>. Përderisa në tenderin e parë kompanitë janë eliminuar për kërkesën e AK për mbështetje të pakushtëzuar nga banka, kërkesë që asnjë OE nuk mund ta plotësonte, pasi asnjë bankë nuk lëshon kredi pa kushte. Paneli kishte marrë pesë vendime deri sa në vendimin e fundit e kishte anuluar tenderin për shkak që të gjithë OE ishin të papërgjegjshëm<sup>48</sup>. Koha e humbur duke llogaritur datën kur është marrë vendimi i parë e deri te vendimi i fundit është 18 muaj.

Në tenderin e dytë një nga pikat ankimore të Sallahut ishte që Bageri nuk ka prezentuar raportet e audituara financiare për vitin 2018. Ky tender ishte publikuar më 4 qershor 2018. Dihet që pasqyrat financiare për një vit që ende nuk kishte përfunduar nuk ka mundësi të dorëzohen e aq më pak të audituara. Pra kjo është një kërkesë e pamundshme që AK

e ka bërë dhe që nuk ka mundësi ta arrijë asnjë OE. Në vendimin 419/18 eksperti Xhevdet Bushi për këtë pikë e cilëson që Bageri nuk e ka plotësuar, pasi thotë që nuk e ka paraqitur raportin financiar të audituar për vitin 2018 siç ka qenë kërkesë në dosje të tenderit. Për më tepër eksperti thotë që AK të kërkojë sqarime nga OE për këtë pikë sipas nenit 72 të LPP-së. Nuk mundet AK të kërkojë sqarime për një raport që do të duhet të kryhet në të ardhmen.

Me këtë rekomandim të ekspertit për çështjen e pasqyrave financiare të audituara për vitin 2018 pajtohet edhe paneli i cili duke u bazuar edhe në disa pika tjera merr vendim që tenderi të kthehet në rivlerësim e njëkohësisht e shpallë të papërgjegjshëm Bagerin<sup>49</sup>.

Paneli në këtë rast për shkak të një kërkesë që nuk mund të arrihet nga asnjë OE është dashur që ose të anulohet tenderin, ose që kërkesa për pasqyrat financiare për vitin 2018 të mos merret parasysh. Paneli ka mundur të marrë për bazë nenin 52.3 të LPP-së i cili thotë:

*Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kriteret që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës. Kriteret e tilla janë por nuk kufizohen në lidhje me: cilësinë, çmimin, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pas-shitjes dhe asistencat teknike.*

Në këtë rast kërkesa për raporte financiare të audituara për vitin 2018 nuk është një kërkesë e matshme. Paneli ka mundur që këtë kërkesë ta trajtojë sipas këtij neni, nëse ka dashur që mos të marrë vendim për ta anuluar tenderin. Paneli përmes vendimit për rivlerësim hapë rrugë përsëri

47 Nyja e Prokurimit Publik. Demokraci Plus. 2017. <http://dplus-ks.org/wp-content/uploads/2017/10/02-Raporti-i-OSHPse-Mars-Qershor-V8.pdf>  
 48 OSHP. Vendimi 521-523/18. 2018. [https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/521-523-17vendim\\_1.PDF](https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/521-523-17vendim_1.PDF)  
 49 OSHP. Vendimi 419/18. 2018. <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/419-18vend.pdf>

që ky tender të shkojë rrugës ankesë-rivlerësim-ankesë, e ndërsa qytetarët të mbesin pa këtë rrugë për gati tri vite.

Pas vendimit të OSHP-së, AK rivlerëson tenderin dhe tani fitues e zgjedh kompaninë Renelual Tahiri. Kundër këtij vendimi ankesë në OSHP bëjnë Sallahu dhe Bageri. Eksperti shqyrtues Hasim Krasniqi thotë që Renelual Tahiri e ka plotësuar kërkesën për raport financiar të audituar për vitin 2018, pasi kishte dorëzuar pas hapjes së ofertave raport financiar të audituar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018 duke mos dhënë shpjegime se si mundet një raport gjashtëmujor të plotësojë kërkesën për raport vjetor të audituar. Eksperti po ashtu e përmend që Bageri për këtë pikë është shpallë i përgjegjshëm në vendimin e kaluar, megjithatë për Renelual Tahiri thotë që është devijim i vogël.

Paneli për këtë pikë merr vendim që Renelual Tahiri nuk e plotëson kërkesën e AK. Paneli merr vendim që tenderi të kthehet përsëri në rivlerësim<sup>50</sup>.

Pas rivlerësimit AK zgjedh fitues OE Eskavatori. Prapë ankesë në OSHP bëjnë kompanitë Bageri, Sallahu dhe Renelual Tahiri. Siç është pretenduar edhe në ankesa e kaluara, përsëri pretendim nga Bageri dhe Sallahu ishte se Eskavatori nuk i kishte pasqyrat e audituara financiare për vitin 2018. Eksperti Hasim Krasniqi aprovon pjesërisht ankesën e Bagerit për këtë pikë dukë thënë që kjo çështje është trajtuar në vendimet e kaluara. Pretendimin e Sallahut nuk e shqyrtoi duke e cilësuar ankesën si të pasafatshme. Paneli kthen tenderin përsëri në rivlerësim<sup>51</sup>. Pretendimi për pasqyrat financiare cilësohet si pjesërisht i bazuar, por paneli shton që Eskavatori i ka dorëzuar këto pasqyra te AK. Eskavatori ka mundur ta bëjë një gjë të tillë pasi viti 2018 kishte përfunduar dhe ka pasur mundësi që t'i përgatisë dhe t'i auditojë.

Që nga shpallja e tenderit të parë më 20 prill 2016 e deri në vendimin e fundit dhe pa paragjykuar që do të ketë përsëri ankesa do të kenë kaluar afërsisht tre vite.

OSHP kurdo që e vëren ose ka pretendime për një kërkesë që është e paligjshme apo e pamundur të plotësohet, duhet ose ta cilësojë si kriter të pamatshëm sipas nenit 52.3 ose të anulojë tenderin. Kjo duhet të bëhet pasi kur një kërkesë nuk mund të plotësohet nga asnjë OE atëherë kjo do të shfrytëzohet për t'u ankuar, e ankesat do të zgjasin pafundësisht nëse paneli i aprovon ato.

## Vendimet për tenderin “Siguria e të dhënave”

Ministria e Administratës Publike (MAP) kishte shpallë tenderin me emër “Siguria e të dhënave”. Në të kishin ofertuar tre OE. Tenderi ishte inicuar më 19 maj 2017. AK kishte anuluar tenderin pasi asnjë nga ofertat nuk ishin të përgjegjshme. Kundër këtij vendimi në OSHP ankesë kishte bërë OE Virtuo. Paneli aprovon ankesën e Virtuo dhe kthen tenderin në rivlerësim<sup>52</sup>.

Pas rivlerësimit MAP zgjedh fitues Virtuon. Kundër këtij vendimi ankesë në OSHP bën Infosoftware Systems, të cilën paneli e aprovon dhe e kthen tenderin përsëri në rivlerësim<sup>53</sup>.

MAP zbaton vendimin e OSHP-së dhe pas rivlerësimit fitues e zgjedh Infosoftware Systems. Ankesë kundër këtij vendimi bën Virtuo. Paneli aprovon ankesën dhe përsëri e kthen tenderin në rivlerësim<sup>54</sup>.

Pas rivlerësimit AK anulon tenderin me arsyen se specifikat teknike janë të paqarta dhe kanë kaluar dy vite prej kur këto

50 OSHP. Vendimi 636-638/18. 2018.  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/636-%20638-18vendim.pdf>

51 OSHP. Vendimi 762/18 10-24/19. 2019.  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2019/762-18%2010-19-24-19vend.pdf>

52 OSHP. Vendimi 304/17. 2017.  
[https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2017/304-17vendim\\_1.PDF](https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2017/304-17vendim_1.PDF)

53 OSHP. Vendimi 501/17. 2017.  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/501-17vend.pdf>

54 OSHP. Vendimi 95/18. 2018.  
<http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/95-18vend.pdf>

specifika janë hartuar e ndërsa teknologjia ecën më hapa të shpejtë përpara. Ekspertja shqyrtuese dhe ai teknik rekomandojnë që tenderi përsëri të kthehet në rivlerësim, ndërsa paneli vendos që të vërtetojë anulimin e tenderit duke u bazuar në arsyetimet që i kishte dhënë MAP<sup>55</sup>.

Kompania e tretë që kishte ofertuar ishte shpallë e papërgjegjshme që në fillim dhe nuk ishte ankuar në OSHP. MAP kishte tre mundësi; të shpallë fitues Virtuon, të shpallë fitues Infosoft Systems ose të anulojë tenderin. Të tri këto AK i kishte bërë deri në vendimin e tretë. Pasi ky tender ka shumë kërkesa teknike të teknologjisë informative, paneli është bazuar tek ekspertët, mirëpo ekspertët për dy vendimet e para dhe dy të fundit, nuk kanë qenë të njëjtit. Paneli duhet që për tenderët ku ka kërkesa që i kupton vetëm eksperti teknik, ai të jetë i njëjtë për të gjitha ankesat pasi kështu sigurohet konsistencë dhe nuk do të kishte rekomandim që edhe në vendimin e katërt tenderi të kthehet në rivlerësim kur AK që në vendimin e tretë i kishte shterur të gjitha mundësitë. Koha e humbur në këtë rast është rreth 10 muaj.

## Vendimet për tenderin “Furnizim me Citostatik nga Lista Esenciale lot 6,14”

Ministria e Shëndetësisë (MSH) kishte publikuar tenderin për furnizim me citostatik nga Lista Esenciale e barnave më 17 korrik 2017. Për llotin 6 (produkti Cistplatin) dhe 14 (produkti Fluouracil) të këtij tenderi MSH kishte anuluar tenderin për shkak që oferta OE Liri Med kishte tejkalluar buxhetin e parashikuar për këto dy lloje. Në dosje të tenderit AK kishte dhënë vlerën e parashikuar për secilin llot. Kundër vendimit të AK në OSHP ishte ankuar Liri Med. Eksperti shqyrtues Xhevdet Bushi, edhe pse e ka parasysh që oferta për llot 6 tejkallon buxhetin për 11.5% dhe për llot 14, 267%, thotë që pasi MSH nuk ka dhënë kontratë për të gjitha llotet, ka akoma mjete në dispozicion. Më tutje ai shton që pasi kjo është kontratë kornizë për 24 muaj, buxheti mund të shtohet nga vitet e ardhshme dhe rekomandon që tenderi të kthehet në rivlerësim.

Një arsytim tjetër i ekspertit është se pas kërkesës për rishqyrtim, MSH e kishte cilësuar si të përgjegjshme ofertën e Liri Med por tenderin e kishte anuluar për tejkalim të buxhetit. AK e ka përmirësuar gabimin e vet në këtë rast pasi nëse një ofertë tejkallon buxhetin nuk mund të cilësohet e papërgjegjshme. Më tej eksperti shton që Liri Med ka prezentuar faturat e disa barnatoreve ku thotë që çmimi i ofruar është më i ulët se çmimi i tregut. Këtë e pranon edhe MSH gjatë seancës dhe shton se Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA), në këtë rast sekretari ka thënë të ju përmbahen buxhetit të planifikuar. Në mënyrë që të shtohet buxheti mbi vlerën e parashikuar ai duhet të aprovohet nga ZKA, që në këtë rast ai nuk e ka aprovuar.

Interpretimi i ekspertit për tejkalim buxheti është i gabuar pasi është e drejtë e AK të pranojë apo jo një ofertë që tejkallon buxhetin e paraparë sipas nenit 62 të LPP-së. Një AK mundet edhe të keqplanifikojë buxhetin, duke planifikuar çmimin e një produkti më të ulët se sa në treg por kjo në asnjë mënyrë nuk do të thotë që AK duhet të shtojë buxhetin nëse një OE ofron mbi vlerën e parashikuar. Interpretimi tjetër i gabuar është ai për llotet dhe kontratën kornizë. Ndarja e vlerës së parashikuar për secilin llot nënkupton që mjetet e destinuara për një llot nuk mund të përdoren për një llot tjetër. Mendimi i ekspertit që mund të paguhet produkti me mjete të llojeve tjera dhe viteve tjera është gabim pasi AK e vendos vlerën e parashikuar për të blerë një produkt me një çmim të caktuar që është edhe maksimumi. Për ta ilustruar më thjeshtë e marrim një shembull:

*AK dëshiron të blejë pesë pako me aspirin me vlerë të parashikuar 10 euro. Kjo nënkupton që maksimumi që AK mund të paguajë për një pako është dy euro. Nëse një OE jep ofertë më të lartë, shembull 15 euro, i bjen që një pako aspirin OE po e ofron për tri euro. Sipas mendimit të ekspertit dhe panelit, pasi është kontratë kornizë AK mund të shtojë mjete nga buxheti i vitit pasues. Por problemi këtu qëndron që AK dëshiron t'i blejë pesë pako me aspirin për 10 euro, e jo për 15 euro.*

55 OSHP. Vendimi 312/18. 2018.  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/312-18%20vend.pdf>

Gjatë seancës kryetari i panelit, Blerim Dina pyet OE se janë të pajtimit të lidhin kontratë me aq sa ka mjete AK, por këtë pyetje nuk ja bën edhe përfaqësuesit të AK-së. Liri Med përgjigjet që është e pajtimit të lidh kontratë me aq sa ka mjete. Paneli vendosë që ta kthej tenderin në rivlerësim me arsyetimin që AK ka parashikuar vlerë jo reale të tregut<sup>56</sup>. Më tej paneli shton që duke marrë parasysh që OE u pajtua që të nënshkruajë kontratë për aq sa ka mjete, atëherë AK është e obliguar që ta bëjë një gjë të tillë. Paneli gjithashtu pati parasysh rëndësinë e këtyre produkteve mjekësore dhe shëndetin e qytetarëve që të mos mbesin për një kohë të gjatë pa këto furnizime.

Nga 1,200 vendime që D+ ka analizuar që nga 1 janari 2017, ky është i vetmi vendim ku OSHP obligon një AK të nënshkruajë kontratë.

Pas rivlerësimit, AK përsëri anulon tenderin me arsyetimin e njëjtë, tejkallim buxheti. Liri Med përsëri ankohet në OSHP. Paneli përveçse aprovon ankesën, këtë herë edhe urdhëron AK që të zbatojë vendimin e kaluar<sup>57</sup>. Paneli e cilëson këtë si rast të gjykuar duke cituar arsyetimet në vendimin paraprak. Të njëjtë gjë e thotë edhe eksperti shqyrtues Xhevdet Bushi, duke rekomanduar përsëri rivlerësim të tenderit.

Pasi paneli ktheu në rivlerësim tenderin për herë të dytë, AK gjatë periudhës së rivlerësimit kishte shpallur tender tjetër për furnizim me citostatik nga Lista Esenciale, duke futur edhe produktin Cistplatin. Përderisa në tenderin e parë ky produkt ishte në llotin 6, tani AK e kishte vendosur në llotin 11. Këtë e kishte vërejtur Liri Med i cili ankohet në OSHP kundër njoftimit për kontratë. Ankesa e tij është për shkelje të nenit 7 të LPP i cili flet për Barazi në trajtim/Jo diskriminim. Eksperti shqyrtues Basri Fazliu rekomandon që ankesa të aprovohet dhe tenderi të anulohet me arsyen që tenderi për këtë produkt është ende në OSHP dhe ende nuk ka ndonjë

vendim (eksperti e kishte fjalën për ankesën 243/18). Eksperti në rekomandimin e tij nuk citon asnjë nen të LPP-së ose Udhëzuesit ku një AK nuk i lejohet që të hapë tender të ri nëse tenderi i parë është në procedurë në OSHP. Gjatë seancës AK deklaroi që tenderin e parë e kemi anuluar për shkak të tejkallimit të buxhetit dhe kanë shpallur tender të ri për shkak të urgjencës pasi për produktin Cistplatin nuk kishin furnizim që nga 6 shkurt 2017.

Paneli merr vendim që tenderi të anulohet pasi produkti Cistplatin që ishte i përfshirë në tenderin e parë, OSHP ka lëshuar urdhëresë për moszbatim të vendimit 24/18<sup>58</sup>. Paneli në vendim konstaton se nuk mund të zhvillohen dy procedura të prokurimit për furnizime të njëjta. Problemi më këtë konstatim është se as LPP e as Udhëzuesi nuk e ndalon një AK që të zhvillojë dy procedura prokurimi për të njëjtat produkte njëkohësisht. Në tenderin e dytë nuk ishte vetëm produkti Cistplatin që kërkohej, por ishin edhe 10 produkte tjera, e OSHP e anuloi komplet tenderin.

Pas urdhëresës 243/18, AK përsëri e anulon tenderin e parë me arsyen e njëjtë, tejkallim buxheti. Eksperti Xhevdet Bushi përsëri rekomandon rivlerësim. Eksperti me të drejtë tani thotë që AK nuk ka respektuar dy vendimet paraprake, ku në vendimin e parë OSHP e kishte detyruar AK që të nënshkruajë kontratën për aq sa ka mjete.

Paneli duke rënë në kundërshtim me dy vendimet e kaluara, vendos që të vërtetojë anulimin e tenderit<sup>59</sup>. Paneli merr për bazë arsyetimin e MSH që e kishte dhënë në të tri seancat, që oferta e Liri Med për llot 6 kishte tejkallim 11.5% dhe për llot 14 tejkallim 270%. Paneli thotë që anulimi është bërë në bazë të nenit 62 i cili thotë që AK mundet të anulojë tenderin nëse ka tejkallim buxheti. Paneli gjithashtu ka parasysh që AK ka bërë hulumtim të tregut në rajon dhe kanë vërtetuar që çmimet e Liri Med janë më të larta se në rajon. Së pari

56 OSHP. Vendimi 24/18. 2018.  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/24-18vendim.pdf>

57 OSHP. Vendimi 243/18. 2018.  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/243-18urdherese.pdf>

58 OSHP. Vendimi 287/18. 2018.  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/287-18vend.pdf>

59 OSHP. Vendimi 479/18. 2018.  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/479-18vendim.pdf>

me këtë hulumtim nuk është konstatuar se ato janë më të larta se çmimi i tregut në Kosovë dhe së dyti as nuk është konstatuar se ato janë më të larta se vlera e parashikuar. Në vendim gjithashtu paneli thotë që është marrë parasysh edhe interesi publik që të mos dëmtohet buxheti, përderisa

në urdhëresën 243/18 kishte thënë që është interes publik shëndeti i qytetarëve.

Për të mos humbur kohën, që për këtë tender është rreth shtatë muaj, OSHP ka mundur që në vendimin e parë të vërtetojë anulimin e tenderit për shkak të tejkalimit të buxhetit.

## Vendim jokonsistent brenda një vendimi

Në tenderin për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve nacionale dhe regjionale operatorët ekonomik Joos Krasniqi dhe Alfa I & Vllaznia Ndërtimi I.S. & Urban & Bageri ishin cilësuar si tenderues të pasuksesshëm për shkak se kishin tejkaluar vlerën e parashikuar për llotin të cilin kishin ofertuar. Eksperti Basri Fazliu rekomandon që dy ankesat të refuzohen pasi është tejkaluar vlera e parashikuar, ndërsa OE e rekomanduara kanë çmime më të lira. Paneli për Joos Krasniqi aprovon ankesën dhe e kthen këtë llot në rivlerësim me arsyetimin se kjo është kontratë kornizë dhe lejohet devijimi +/-30%. Por paneli vendos ndryshe për konzorciumin Alfa I & Vllaznia Ndërtimi I.S. & Urban & Bageri<sup>60</sup> duke përdorur të njëjtin arsyetim për kontratën kornizë por thotë që konzorciumi është palë pa interes juridik dhe material pasi ka OE më të lirë që është rekomanduar për kontratë.

Interpretimi i panelit për kontratën kornizë është i njëjtë si në rastin e tenderit të MSH ku ankues ishte Liri Med. Në këtë tender MI kishte dhënë edhe vlerën e parashikuar për secilin llot. Në llotin ku kishte ofertuar Joos Krasniqi vlera e parashikuar ishte 1,579,083.20 euro, ndërsa oferta e Joos Krasniqi ishte 2,115,616.40 euro. Paneli thotë që duke pasë parasysh rëndësinë e këtij tenderi, sipas nenit 38.2 të LPP kontrata ndërpritet në momentin që shpenzohet vlera e parashikuar. Problemi këtu qëndron se AK ka dashur që të blejë sasinë e shërbimit për maksimum vlerën e parashikuar. AK në dosje të tenderit paramasën e ka ndërtuar për të ofruar çmim për njësi. Kjo metodë përdoret kur AK nuk e din sasinë dhe sipas

nenit 56.11<sup>61</sup> të Udhëzuesit në këtë rast nuk vlen pragu prej +/-30%. AK me të drejtë e kishte cilësuar ofertën e Joos Krasniqi si të pasuksesshme pasi kishte tejkaluar vlerën e parashikuar.

Për ofertën e konzorciumit Alfa I & Vllaznia Ndërtimi I.S. & Urban & Bageri paneli përdor të njëjtin arsyetim si për Joos Krasniqi por shton që ka ofruar çmim më të lartë se OE i rekomanduar. Të njëjtën gjë e kishte bërë edhe Joos Krasniqi. Vlera e parashikuar për llotin Mitrovica 1, ku kishte ofertuar konzorciumi Alfa I & Vllaznia Ndërtimi I.S. & Urban & Bageri ishte 1,330,298.96, ndërsa oferta 1,731,902.40 euro.

Paneli në vendimin për Joos Krasniqin vetëm çka ka bërë që të humbet koha pasi përsëri është zgjedhur fituesi i njëjtë, RSM Company. Për të dy ankesat paneli bazohet në nenin 38.2 të LPP që flet për kontratën kornizë. Të dy ankuesit kishin tejkaluar vlerën e parashikuar. Kurdo që tejkalohet vlera e parashikuar, nëse AK nuk shpreh interes që do të aprovojë buxhet shtesë është më mirë që të vendoset që ankesa për këtë pikë të refuzohen. Siç ka ndodhur në këtë rast AK edhe pas rivlerësimit nuk aprovon buxhet shtesë. Kjo bën që të humbet koha e për këtë aktivitet të prokurimit koha është shumë e rëndësishme.

60 OSHP. Vendimi 337-343-349-354-357/18. 2018.

<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/337-343-349-354-357-18v6ndim.pdf>

61 Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik. 2017.

<https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/STRforms2017/sq/RREGULLAT%20dhe%20UDHEZUESI%20OPERATIV-01062017.pdf>

## VENDIMET PËR LISTËN E ZEZË

AK kur kanë dyshime që një OE ka paraqitur të dhëna të rreme ose ka falsifikuar ndonjë dokument, bëjnë kërkesë në OSHP për ta diskualifikuar një OE nga pjesëmarrja në aktivitete të prokurimit për një periudhë të caktuar. Vendimet për diskualifikim, OSHP i kategorizon si vendime për listë të zezë. Në listë të zezë një OE mund të futet për maksimum 12 muaj sipas nenit 99.2 të LPP-së.

OSHP për periudhën qershor – dhjetor 2018 ka marrë 15 vendime për listën e zezë. Të gjitha kërkesat e AK-ve për futje në listë të operatorëve të cilët kanë tentuar të mashtrojnë, janë refuzuar nga OSHP. Që nga 1 janari 2017, OSHP ka marrë 36 vendime për listë të zezë, ku vetëm gjashtë prej tyre janë aprovuar.

Mirëpo, edhe përkundër këtyre vendimeve të OSHP-së, lista e zezë nuk është që ka pasur ndonjë efekt, pasi njëri nga OE të diskualifikuar, Pastor Kosova, ka aplikuar dhe ka fituar në një tender edhe pasi është diskualifikuar. Në vendimin 1135/17 të datës 14 mars 2018 OSHP e kishte diskualifikuar për gjashtë muaj Pastor Kosovën për shkak se kishte falsifikuar një autorizim<sup>62</sup>. Në bazë të vendimit, Pastor Kosova nuk do të kishte të drejtë të merrte pjesë në aktivitete të prokurimit për gjashtë muajt e ardhshëm. Por, kompania në fjalë kishte ofertuar dhe fituar në një tender i cili ishte shpallur pas datës 14 mars 2018. Gjykata Themelore në Gjakovë kishte publikuar njoftimin për vendimin e AK më 1 qershor 2018 ku kontratën ja kishte dhënë Pastor Kosovës me çmim 1,054.92 euro<sup>63</sup>. Kjo është një e metë e sistemit të prokurimit në të cilën nuk merren masat për t'i pamundësuar këtyre operatorëve që të ofertojnë, qoftë duke i suspenduar nga platforma e e-Prokurimit apo duke gjetur një formë tjetër të përshtatshme.

Nga 15 kërkesat për diskualifikim që OSHP i kishte refuzuar, arsyetimet e panelit janë pothuajse të njëjta, “AK nuk ka dëshmi që OE ka ofruar dëshmi të rreme ose dokument të falsifikuar sipas nenit 99.2 të LPP-së”. Interpretimi se çka konsideron paneli dëshmi të rreme ose falsifikim është edhe baza pse këto kërkesa janë refuzuar.

Një nga kërkesat për diskualifikim e kishte bërë Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) kundër OE Commando. AQP e kishte shpallë fitues Commandon dhe para publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës kishte kërkuar që Commando të sjellë, ndër të tjera, edhe vërtetimin e ATK-së që nuk ka borxhe. AQP e kishte pritur për disa ditë, ndërsa Commando në fund të afatit kohor kishte deklaruar se kishte borxhe ndaj ATK-së. Paneli merr vendim që kërkesa të refuzohet me arsyen se Commando nuk ka dhënë të dhëna të rreme ose dokument të falsifikuar<sup>64</sup>.

Një OE gjatë përgatitjes së ofertës së tij, në dosje të tenderit nënshkruan deklaratën nën betim e cila thotë:

*“Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.”*

62 OSHP. Vendimi 1135/17. 2018.

<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/1135-17vend.pdf>

63 Gjykata Themelore e Gjakovës. Njoftim për vendimin e AK. 2018.

[https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN\\_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=159145](https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=159145)

64 OSHP. Vendimi 723/18. 2018.

<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/723-18lz.PDF>



Neni 65.4.8 i LPP-së flet pikërisht për vërtetimin e ATK-së, e që siç është përmendur më lartë, OE nuk ka të drejtë as të ofertojë nëse ka borxhe ndaj ATK-së. Pasi vërtetimi i ATK-së kërkohet për tremujorin e fundit para publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës, Commando nuk ka mundur që borxhin ta krijojë gjatë periudhës në mes shpalljes së tenderit dhe përzgjedhjes së fituesit pasi kjo periudhë në këtë tender ka zgjatur rreth një muaj. Pra, Commando e ka ditur se ka borxhe ndaj ATK-së, ka deklaruar përmes deklaratës nën betim që i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë sipas nenit 65, e sipas D+ kjo mund të interpretohet se ka paraqitur të dhëna të rreme madje duke e nënshkruar edhe deklaratën nën betim, gjë e cila do të shtonte përgjegjësinë e OE. Sipas këtij interpretimi Commando do të duhej të diskualifikohej.

Po të kishte një mekanizëm të ndarjes së informatave në mes të ATK-së dhe KRPP-së, në fakt Commando as nuk do të duhej të lejohej të ofertonte pasi neni 65.4.8 në këtë rast thotë që një OE nuk lejohet të ofertojë nëse është me vonesë në pagesën e tatimeve.

Edhe një vendim tjetër që ka të bëjë për vërtetimin nga ATK, është vendimi për kërkesën e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) kundër kompanisë Astraplan. Këtë kërkesë OSHP e kishte refuzuar përsëri me të njëjtin arsyetim, që MFSK nuk ka dëshmi që Astraplan ka paraqitur të dhëna të rreme ose falsifikim të dokumentit<sup>65</sup>. AK e kishte zgjedhur fitues Astraplan edhe pse ky i fundit nuk kishte dorëzuar vërtetimin nga ATK, së pari me arsyen që ka qenë jashtë Kosovës e pastaj me arsyen që kur është futur në sistem të ATK-së për të nxjerrë vërtetimin është habitur kur e ka parë që ka borxhe. Një deklaram i çuditshëm i ekspertit është kur thotë që AK ka masa tjera që mund të marrë ndaj Astraplan.

Edhe për këtë kërkesë paneli do të mund të vepronte sipas interpretimit që OE nuk ka ofruar sipas kushteve që i ka pranuar në deklaratën në betim.

Një vendim tjetër ku OSHP kishte refuzuar kërkesën për diskualifikim është edhe kërkesa e Komunës së Vushtrrisë kundër kompanisë Commando. Komuna kishte kërkuar diskualifikim pasi Commando e cila kishte fituar kontratën, nuk kishte paguar për një pjesë të punëtorëve kontributin pensional prej 5% ashtu siç parashihet me Ligjin e Punës. Këtë konstatim të komunës e kishte mbështetur edhe eksperti Basri Fazliu. Në dosje të tenderit komuna shprehimisht e kishte cekur se pagës neto duhet t'i shtohet tatimi, kontributi pensional i punëtorit dhe i punëdhënësit. Paneli përsëri duke përdorur arsyetimin e njëjtë si në vendimin për kërkesën e AQP-së refuzon kërkesën për diskualifikim<sup>66</sup>. Paneli shton gjithashtu që AK në rast se ka mosmarrëveshje lidhur me zbatimin e kontratës ajo të zgjidhet duke u bazuar në Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve<sup>67</sup>.

Për këtë çështje paneli ka mundur që ta interpretojë Formularin për dorëzimin e tenderit i cili parasheh:

*2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:*

Sipas këtij neni, Commando përderisa ka dorëzuar tenderin është pajtuar me kushtet e dosjes së tenderit, e një nga kushtet pra ka qenë që të paguajë kontributin pensional të punëdhënësit. Paneli do të mund ta diskualifikonte, i cili është një vendim administrativ, ndërsa komuna do të mund të ia konfiskonte sigurinë e ekzekutimit dhe dërgonte këtë lëndë në gjykatë për shkelje të Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës.<sup>68</sup>

65 OSHP. Vendimi 737/18. 2018  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/737-18lz.PDF>

66 OSHP. Vendimi 1078/18. 2018.  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/1078-18%20%20end%20disk.pdf>

67 Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. 2012.  
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2828>

68 Ligji Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. 2012.  
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2815>



# REKOMANDIMET E EKSPERTËVE

Ekspertët e OSHP janë persona që paneli përzgjedh për të bërë një ekspertizë në lidhje me ankesat e OE. Janë dy kategori të ekspertëve; ekspertët shqyrtues që merren me shqyrtimin e pretendimeve që lidhen me procedurat e prokurimit, LPP dhe Udhëzuesin, si dhe ekspertët teknik që kanë njohuri më të thella për një fushë të caktuar. Përzgjedhja e tyre bëhet në bazë të shkollimit dhe njohurive që ata kanë për një fushë të caktuar. Rekomandimet e ekspertëve janë shumë me rëndësi pasi paneli në mungesë të njohurive profesionale për shumë fusha të caktuara vendos duke u bazuar në rekomandimet e ekspertëve.

Në pjesën më poshtë paraqiten rastet kur ekspertët kanë gabuar në rekomandimet e tyre. Në disa prej këtyre rasteve paneli ka marrë vendim sipas rekomandimit të ekspertit e në disa raste ka vendosur ndryshe.

## Marisa & Gërlica v. Komuna e Gjakovës, 450/18

Një OE para së të ankohet në OSHP, fillimisht duhet të bëjë kërkesë për rishqyrtim në AK brenda pesë ditësh nga publikimi i njoftimit për kontratë, njoftimin për dhënie kontrate ose njoftimin për anulim. Pas kësaj AK ka kohë tri ditë pune që t'i kthej përgjigje OE ankues. Nëse AK nuk kthen përgjigje për çfarëdo arsye, atëherë OE mund të bëjë ankesë në OSHP pa pritur përgjigjen e AK<sup>69</sup>.

Konzorciumi Marisa & Gërlica ishte ankuar në OSHP me pretendimin që AK nuk i kishte kthyer përgjigje në kërkesën për rishqyrtim. Ekspertja shqyrtuese Abetare Prebreza nuk ishte marrë me pretendimet ankimore, por kishte rekomanduar

që ankesa të cilësohet e pasafshme pasi OE ankues kishte tejkaluar afatin ligjor prej dhjetë ditëve për parashtrim të ankesës. Sipas ekspertës Marisa & Gërlica ankesën në OSHP e kishte bërë në ditën e 12-të. Ekspertja ka dhënë rekomandim të gabuar pasi nuk ka llogaritur si duhet afatet kohore.

Marisa & Gërlica kishin bërë kërkesë për rishqyrtim me 10 gusht 2018. Sipas nenit 108/A AK ka afat tri ditë pune për të kthyer përgjigje dhe në raste të jashtëzakonshme këtë afat mund ta shtyjë edhe për tri ditë tjera me kusht që OE të njoftohet, gjë të cilën komuna e kishte bërë. Pasi OE kërkesën për rishqyrtim e kishte bërë më 10 gusht 2018 që ishte ditë e premte, AK kishte kohë tri ditë pune për t'i kthyer përgjigje, që do të thotë përgjigje do të duhej t'i kthente më datë 15 gusht, e mërkurë. Të enjten më 16 gusht, AK kërkon të shtyjë afatin për përgjigje edhe për tri ditë tjera. Me afatin e ri AK do të duhej t'i kthente përgjigje deri më 21 gusht, e martë. AK i kthen përgjigje, por në email të anëtarit të konzorciumit e jo në atë të liderit me të cilin kishte ndodhur komunikimi deri në atë moment. Po të interpretohet kjo që AK nuk i ka kthyer përgjigje fare OE ankues, atëherë OE ankues mund të bënte ankesë në OSHP prej datës 22 gusht, e mërkurë. Marisa & Gërlica bënë ankesë në OSHP më datë 29 gusht, që është brenda afatit ligjor prej dhjetë ditëve.

Paneli nuk merr parasysh rekomandimin e ekspertës dhe merr vendim që ankesa të aprovohet e tenderi të kthehet në rivlerësim. Në arsyetim paneli bazohet pikërisht në nenin 108/A.<sup>70</sup>

69 KRPP. Neni 8.2 i formularit F03 Rregullat për parashtrim të ankesave-Verzioni 2. 2016 [https://krpp.rks.gov.net/krpp/PageFiles/File/STRforms2016/Shqip/F03%20Rregullat%20per%20parashtrim%20te%20ankesave\\_26.04.2016.docx](https://krpp.rks.gov.net/krpp/PageFiles/File/STRforms2016/Shqip/F03%20Rregullat%20per%20parashtrim%20te%20ankesave_26.04.2016.docx)

70 OSHP. Vendimi 450/18. 2018. <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/450-18vendim.pdf>

## SNR v. Trepça, 278/18

OE SNR ishte ankuar në OSHP kundër vendimit të AK Trepça për dhënie të kontratës me pretendimin ankimor se SNR ishte eliminuar pasi kishte dorëzuar certifikatën ISO 18001 me afat të skaduar. Eksperti Basri Fazliu thotë se një OE nuk mund të eliminohet për një kërkesë që nuk është në dosje të tenderit. Kërkesa për certifikatë ISO 18001 ishte shtuar në njoftimin për korrëgjim të gabimeve, të cilën eksperti siç duket nuk e ka vërejtur. Rekomandimi i tij ishte që tenderi të kthehet në rivlerësim. Duke përsëritur arsyetimet e ekspertit, paneli merr vendim që tenderi të kthehet në rivlerësim, ndërsa ankesa të aprovohet<sup>71</sup>. Eksperti shqyrtues po ta vërente që edhe ISO 18001 kërkohet në dosje të tenderit, atëherë rekomandimi i tij do të duhej të ishte që të vërtetohet vendimi i AK. Me këtë rekomandim edhe paneli do të mund të merrte vendim që të vërtetohet vendimi i AK.

## Sigma v. Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës, 396/18

OE Sigma ishte ankuar në OSHP kundër vendimit të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës për dhënie të kontratës. Pretendimi ankimor i Sigma ishte se OE fitues nuk kishte ofruar në dosje të tenderit certifikatë nga risiguruesi. Në dosje të tenderit kërkohet që OE të jenë risiguruar në kompani më të mëdha që kanë klasifikim A+ sipas klasifikimit të bërë nga kompania Standard & Poor's. OE fitues kishte një dokument ku thuhet se Butcher Robinsone & Staples International Limited do të konsideronte të ofrojë (në anglisht termi i përdorur në këtë dokument është "will consider") mbulim të risigurimit deri në 100%. Këtë e thotë edhe eksperti i cili përdor fjalën mund të ofrojë mbulim fakultativ të risigurimit deri në 100%. Eksperti Hysni Muhadri konsideron që kjo e plotëson kërkesën e AK. AK kishte kërkuar risigurim e jo ndonjë dokument ku një kompani do ta konsideronte risigurimin. Përndryshe OE ankues në këtë rast e kishte ofruar dokumentin ashtu siç kërkohet me dosje të tenderit.

Eksperti me këtë interpretim të gabuar rekomandon që ankesa të refuzohet.

Paneli në arsyetimin e vendimit e ka parasysh se dokumenti i OE fitues ka fjalët "mund të sigurohet", ndërsa ai i OE ankues thotë që është "i risiguruar". Në vendim gjithashtu fjala "mund" është e theksuar me ngjyrë të zezë, për të treguar që tek kjo fjalë është dallimi. Paneli vendos që ankesa të aprovohet dhe tenderi të kthehet në rivlerësim<sup>72</sup>.

## CDC v. Komuna e Gjilanit, 542/18

Kundër vendimit së Komunës së Gjilanit për dhënie të kontratës, në OSHP ishte ankuar kompania CDC. Komuna e kishte eliminuar për shkak se kishte kërkuar mini eskavator deri në tre ton dhe për çmim jonormalisht të ulët. CDC kishte deklaruar se eskavatori ka kapacitet 0.4 m<sup>3</sup> por në dokumentin unik doganor (DUD) pesha e tij ishte 4250 kg, pra më shumë se tre ton. Çmimi i ofruar nga CDC, në bazë të formulës ishte jonormalisht i ulët. Komuna kishte respektuar procedurat dhe i kishte dërguar kërkesë për të sqaruar çmimin. CDC kishte kthyer përgjigje duke sqaruar çmimin e ofruar, por komuna nuk ishte bindur në këtë sqarim.

Eksperti shqyrtues Burim Guri në rekomandimin e tij thotë se edhe pse CDC ka ofruar eskavator me peshë më të lartë, kjo përbënë një devijim të vogël dhe lejohet sipas nenit 59.4 të LPP-së. Këtë arsyetim eksperti e mbështet edhe në çmimin e ofruar nga CDC, që ishte për rreth 70,000 euro më i ulët se çmimi i OE fitues. Mirëpo sipas nenit 60 të LPP-së një tender së pari duhet të jetë i përgjegjshëm e pastaj vlerësohet sipas çmimit më të lirë. Për kërkesën e AK për peshën e caktuar të eskavatorit (deri në tre ton) ka arsye legjitime e që është mundësia për dëmtim të rrugës nga eskavator me peshë më të larta.

Për çmim jonormalisht të ulët, ku AK nuk ishte bindur në shpjegimet e OE CDC, eksperti nuk e ka parasysh këtë, vetëm

71 OSHP. Vendimi 278/18. 2018.  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/278-18vend.pdf>

72 OSHP. Vendimi 396/18. 2018.  
[https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/396-18vendim\\_1.PDF](https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/396-18vendim_1.PDF)

thotë që CDC ka shpjeguar të gjitha çmimet. Ky është një interpretim i gabuar i ekspertit, pasi që tenderi i CDC, përveç se me formulë del të jetë jonormalisht i ulët, edhe AK nuk është bindur në sqarimet e ofruara.

Paneli nuk i merr parasysh rekomandimet e ekspertit, ndërsa vërteton vendimin e AK për dhënie të kontratës<sup>73</sup>. Arsyetimi i panelit ishte se CDC nuk ka ofruar eskavator sipas kërkesës së AK dhe tenderi i tij ishte jonormalisht i ulët ku edhe AK nuk ishte bindur në sqarimet e ofruara.

### **Gërlica v. Komuna e Ferizajt, 616/18**

Gërlica Company ishte ankuar në OSHP kundër vendimit të Komunës së Ferizajt për dhënie të kontratës. Një nga arsyet që AK e kishte eliminuar këtë kompani ishte fakti që diploma e gjeodetit ishte në gjuhën maqedone e sipas LPP, neni 13.4, dokumentet mund të ofrohen vetëm në shqip, serbisht ose anglisht. Ekspertja shqyrtuese Es'heme Beka thotë se në dosje të tenderit nuk është kërkuar që diploma të jetë e përkthyer. Ky është një interpretim i gabuar që shpesh e bëjnë ekspertët. Kjo kërkesë buron nga LPP dhe nuk mund të vendosen të gjitha kërkesat nga ligji si kriter në dosje të tenderit, pasi ashtu dosja do të bëhej shumë voluminoze. Ekspertja për shkak të disa çështjeve tjera për të cilat ishte eliminuar OE ankues rekomandon që tenderi të anulohet për shkak se asnjëri nga OE nuk kishte validitet të ofertave.

Paneli nuk e merr parasysh interpretimin e ekspertës për diplomë dhe mbështet në nenin 13.4 të LPP-së, ndërsa për validitet të ofertave thotë që OE fitues e ka vazhduar vetë atë. Vendimi ishte që të vërtetohet vendimi i AK për dhënie të kontratës<sup>74</sup>.

73 OSHP. Vendimi 542/18. 2018.  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/542-18vend.pdf>

74 OSHP. Vendimi 616/18. 2018.  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/616-18vendim.pdf>

## Rekomandimet jokonsistente të ekspertëve

Në vendimin 23/17 eksperti Muhamet Kurtishaj rekomandon që të mbetet në fuqi vendimi i AK për dhënie të kontratës, pasi sipas verifikimeve që eksperti i kishte bërë në internet, OE ankues Euroing nuk kishte ofruar produktin sipas kërkesës së KEK-ut. Eksperti thotë që produktit të ofruar i mungonte elementi AR-alkool rezistent. Paneli merr vendim që të vërtetohet vendimi për dhënie të kontratës pasi produktit të ofruar nga OE ankues i mungonte elementi “alkool rezistent”<sup>75</sup>.

Një vendim tjetër, i të njëjtit ekspert, thotë se nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit që produkti i ofruar nga OE ankues Feroda Commerce të krahasohet me faqen e prodhuesit në internet. Sipas tij, jo çdo prodhues i vendos produktet e veta në faqen e internetit. AK kishte dyshuar në specifikat teknike të ofruar nga Feroda, ku pastaj e kishte bërë verifikimin e këtyre specifikave përmes faqes së internetit të prodhuesit Elanit. AK pasi ka verifikuar, ka parë se si specifikë e produktit në faqen e Elanit, temperatura e ngjitjes ka qenë e shënuar 20-30 gradë dhe kushtet e punës 20-30 gradë, ndërsa KEK kishte kërkuar temperaturën të jetë -20 deri 40 gradë. AK sqaron gjithashtu që produkti është i një rëndësie të veçantë, dhe duhet që Elanit ta kishte në faqe. Dyshimi i AK ishte rritur kur Elanit e kishte fshirë nga faqja këtë produkt. Gjatë seancës eksperti deklaroi se AK nuk ka kërkuar që specifikat teknike të ofruar nga OE, duhet të jenë në përputhje me specifikat teknike që janë në faqe të prodhuesit. Eksperti ka mundur që për këtë pikë të kërkojë nga AK që këto dyshime t'i sqarojë me prodhuesin, por rekomandon që tenderi të kthehet në rivlerësim, në kuptimin që ju është bërë e padrejtë OE ankues.

Paneli vendos që tenderi të kthehet në rivlerësim<sup>76</sup>. Paneli ka parasysh sqarimet e ekspertit dhe gjithashtu përmend se nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit që produktet e ofruara duhen të jenë edhe në faqen e prodhuesit. Në fund paneli shton se AK është dashur që këtë ta sqarojë me prodhuesin nëse ka pasur dyshime.

Është e vërtetë që në dosje të tenderit nuk kërkohen që produktet të jenë të vendosura në faqet e prodhuesve, por për AK ky është një mekanizëm të cilin mund ta përdorë nëse ka dyshime që produkti i ofruar nuk ka specifikat teknike sipas atyre që gjenden në faqen e prodhuesit. Siç D+ ka gjetur në raportin “Drejt Komunave me Prokurim të Hapur, Llogaridhënës dhe Efikas”<sup>77</sup> ka raste kur dyshohet që OE ndryshojnë të dhënat në katalogje, në mënyrë që ato të përshtaten më specifikat e kërkuara. Krahasimi më faqen e prodhuesit në këtë rast është një mekanizëm i besueshëm që AK mund ta përdorë për ta verifikuar se nuk kemi mashtrim potencial nga ofertuesit.

75 OSHP. Vendimi 23/17. 2017.  
[https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2017/23-17vendim\\_1.PDF](https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2017/23-17vendim_1.PDF)

76 OSHP. Vendimi 292/18. 2018.  
<https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/292-18vend.pdf>

77 Drejt Komunave me Prokurim të Hapur, Llogaridhënës dhe Efikas. Demokraci Plus. 2018  
<http://www.dplus-ks.org/wp-content/uploads/2018/12/2018-12-03-Drejt-komunave-me-prokurim-t%C3%AB-hapur-llogaridh%C3%AB-n%C3%ABs-dhe-efikas-ALB-Final.pdf>

# REKOMANDIME

Duke u bazuar në gjetjet e këtij raporti, dhe monitorimin e vazhdueshëm të OSHP-së, D+ i propozon këto masa për të përmirësuar mekanizmin e procedimit të ankesave në prokurim publik:

- OSHP të marrë një qëndrim në lidhje me shqyrtimin e pretendimeve të cilat kanë të bëjnë me shkeljet e ligjeve të veçanta apo legjisllacionit dytësor. OSHP të vendos nëse do t'i trajtoj këto shkelje apo do t'i përcjellë tek organet e tjera për të marr vlerësim në lidhje me këto shkelje;
- OSHP të krijojë një databazë të avancuar të vendimeve të saj, në mënyrë që ta ketë më të lehtë t'i gjejë vendimet për një çështje të caktuar për të siguruar konsistencë në vendimmarrje. Kjo do të shtonte rëndësinë e precedentit në shqyrtimin e ankesave;
- OSHP të bëjë monitorimin dhe kontrollin e ekspertëve për të siguruar cilësi dhe paanshmëri, e sidomos kur ndaj tyre ka pretendime se nuk e kanë kryer punën si duhet. Secilit ekspert duhet t'i bëhet matje e cilësisë duke përcjellur suksesin e rekomandimeve të tij/saj, afatin e trajtimit të lëndëve dhe indikatorë të tjerë, për të përcaktuar nëse duhet të mbahet si i tillë në OSHP apo të zëvendësohet me të tjerë;
- OSHP të marrë qëndrim rreth interpretimeve të KRPP-së, pasi në disa raste i konsideron interpretimet e KRPP si obligative e në disa raste jo;
- OSHP të ndryshojë interpretimin për diskualifikim të operatorëve ekonomik, pasi interpretimi aktual është shumë i ngushtë dhe i lejon personat që kanë deklaruar rrejshëm të mbesin të pa ndëshkuar;
- Operatorët e përfshirë në listën e zezë të suspendohen nga platforma e e-Prokurimit dhe OSHP duhet të kërkojë nga KRPP që të suspendohen kompanitë në listë të zezë;
- OSHP t'i kushtojë vëmendje më të madhe zbatimit të vendimeve të saj, duke krijuar mekanizma monitorues të zbatimit të vendimeve dhe të aplikojë masa ndëshkuese për AK të cilat nuk i zbatojnë vendimet apo të cilat shkelin afatet;
- Të mbahen seancat e hapura për të gjitha ankesat;
- Të bëhet publikimi i të gjitha vendimeve, ankesave, raporteve të ekspertëve si dhe dokumenteve tjera që janë me rëndësi, në një format të lexueshëm elektronikisht;
- Të shtohet bashkëpunimi me institucionet e ndjekjes, si prokuroria dhe policia, për të adresuar gjetjet që kanë elemente të veprës penale.

